

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7840 E mërkurë 3 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**

Nëse ju kujtohet, rreth 25 vjet më parë, "të dehur" nga liria e tepruar pas daljes nga diktatura komuniste si dhe nga milionat e lekëve të fituar fare pa djersë nga "firmat ...  
Vijon në faqet 20-21

Nga XHEVAT MUSTAFA

**Bobo, çfarë i kemi bërë vetes ne shqiptarët?!**



**Opinion** *i* **Ditës**

Shteti për shkak të puçit politik të Skapjes nga Rilindja është shpërbërë strukturalisht, juridikisht dhe moralisht. Kryekauza e opozitës është natyrshëm ...  
Vijon në faqen 21

Nga PETRIT VASILI

**Çirimi i shtetit nga kapja, kryekauzë e qartë e opozitës**



Kryeministri: Lul, do marrësh Noc Rrokun

## Edi Rama në Librazhd: PD-LSI, drejt shkrirjes. Ballat: Duan të pengojnë drejtësinë dhe integrimin

Kryeministri rrëzon mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme: Opozita tradhtoi popullin

Kryeministri Edi Rama përjashtoi çdo mundësi që negociatat dhe marrëveshja me opozitën e vitit 2017 të përsëritet sërish edhe kësaj here për t'i dhënë zgjidhje krizës politike. Nga Librazhdi ku zhvilloi takimin e radhës "Bashkia që duam", kryeministri Edi Rama u shpreh prerazi se nuk do të pranonte një tryezë të ngjashme me atë të vitit 2017 që të negociante ...  
Në faqen 2

## SHKODER/ BORXHDHENESIT AKUZOJNE PAULIN RADOVANIN: NA KTHE PARATE

# TE ARRESTUARIT PER FAJDE: ISH-PREFEKTI BLINTE VOTAT

Zbardhen dëshmitë e 12 të akuzuarve në gjyq, akuza ndaj djemve të Radovanit.  
Edi Memçaj: Paratë tona janë bërë drogë e kumar, i kisha të ligjshme



(Në foto) Ish-prefekti i Shkodrës, Paulin Radovani

**INTEGRIMI NE BE**  
**Han: Tashmë është koha, rekomandim pozitiv për hapjen e negociatave**  
Në faqen 4

**KRYETARI I PD**  
**Basha: Duan të na likuidojnë, por nuk ka makineri që e shtyp opozitën**  
Në faqen 3

**SAMITI I PPE**  
**Reagon Doris Pack: Ambasadorët mbyllin sytë për situatën e rëndë në Shqipëri**  
Në faqen 4

**FLET PESHENGRITËSI**  
**Erkand Qerimaj: I treti në Botërorin e SHBA, gati për lojërat olimpike**  
Suplement

**NIS SISTEMI I RI**



**"Shoferët e mirë" do paguajnë më pak për siguracionin e automjeteve**  
Në faqen 7

Shpallet në kërkim gruaja 49-vjeçare. Dyshohet se mashtruan për përfitim

## Skema, 20 mijë euro për një pasaportë shqiptare

Arrestohet arabi, u premtonte egjiptianëve dokumente për në Europë

TIRANË - Një shtetas arab është arrestuar nga policia për mashtrim, pasi në bashkëpunim me dy shqiptarë, duke u hequr si investitorë në Shqipëri, u premtonte shtetasve të huaj me kombësi egjiptiane pasaporta të shtetit shqiptar për shuma që varionin mbi 20.000



euro. Mësohet se seksioni për Krimin Ekonomik dhe Financiar në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të operacionit të koduar "Përshpejtimi", arrestoi shtetasin Talal Ahmed Abu Mayha, 41 vjeç, lindur ...  
Në faqen 9

## KRIZA REFUZIMI

Kreu i PS-së hodhi poshtë çdo mundësi për të negociuar mandatin e qeverisë

# Rama: PD dhe LSI po shkrihen, 'Noc Rrokun' do marrësh Lul

PS vijoi turin "Bashkia që duam" në Librazhd

Kryeministri Edi Rama përjashtoi çdo mundësi që negociatave dhe marrëveshja me opozitën e vitit 2017 të përsëritet sërish edhe kësaj here për t'i dhënë zgjidhje krizës politike. Nga Librazhdi ku zhvilloi takimin e radhës "Bashkia që duam" kryeministri Edi Rama u shpreh prerazi se nuk do të pranonte një tryezë të ngjashme me atë të vitit 2017 që të negocionte fatin mandatin të qeverisë së tij. "Nuk ka më me gjysma-gjysma. Nuk ka më asnjë lloj tryeze për të negociuar mandatin që na keni dhënë ju, se nuk na e keni dhënë mandatin t'i japim pushtet Lulit, por na e keni dhënë mandatin që pushtetin tuaj që buron nga vota juaj ta përdorim për të vazhduar të fuqizojmë ekonominë, të rrisim punësimin, të vazhdojmë rindërtimin e shkollave, rindërtimin e qendra shëndetësore, të bëjmë infrastrukturën, të mbështesim fermerët, të rrisim agrobiznesin pak nga pak dhe të krijojmë kushte më të mira për ata që vijnë pas nesh. Për këtë na e keni dhënë mandatin ju", - tha kryeministri Edi Rama në fjalën e tij para banorëve të Librazhdit. Sipas tij opozita dhe në mënyrë të veçantë dy forcat kryesore të saj me sjelljen që po bëjnë duke braktisur mandatin që i dha populli dhe duke dalë jashtë institucioneve, po shkojnë drejt shkrirjes së tyre. "Ata zgjedhën të bëjnë diçka që askush nuk e ka bërë. Ka vetëm një parti që e ka bërë atë që bëjnë ata në vitet '20, në Itali. Edhe ajo parti që e bëri atë në vitet '20 në Itali u shkri fare. Ashtu do shkrihen dhe ata. Këtu do jeni. Ashtu do shkrihen dhe ata, sepse zgjedhën të tradhetojnë popullin e tyre, popullin që i votoi ata, popullin të cilin ia morën mandatin për të shkuar, për t'i përfaqësuar në parlament dhe tani çfarë bëjnë? Djejin mandatin, futen me turmë dhe iu thonë njerëzve "ne jemi si ju". Tani,



Kryeministri Edi Rama

### "Përpjekje për të nxirë imazhin e Shqipërisë"

## Taulant Balla: 2 qëllimet e opozitës, bllokimi i drejtësisë dhe i integritetit

Djegia e mandateve nga Rama e opozitës ka si qëllim pengimin e reformës në drejtësi, si dhe hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Kështu u shpreh sekretari i përgjithshëm i Partisë Socialiste, Taulant Balla, gjatë një interviste, duke i cillësuar këto si 2 nga qëllimet e PD dhe LSI. "Ne nuk kemi kohë për të humbur, shqiptarët nuk kanë kohë për të humbur. 30 qershor është një moment i rëndësishëm për të vlerësuar modelin se ku duhet të ecin qytetet dhe bashkitë. PD dhe LSI kanë sot vetëm 2 qëllime. Qëllimi i parë është pengimi i mëtejshëm i reformës në drejtësi, edhe dorëzimi i mandateve ishte për të penguar vijimin e mëtejshëm të një reforme,



që është historike për shqiptarët. Dhe e dyta, është pikërisht përpjekja për të penguar hapjen e negociatave në qershor. E gjithë kjo përpjekje e tyre po bëhet për të nxirë imazhin e Shqipërisë përballë vendeve anëtare të BE", - theksoi Balla. Sipas Ballës, me hapjen e negociatave, PD dhe LSI do të merr-

"hidhuni ju dignini", "hidhuni ju shkatërroni", "bëni rrëmuje", "shkoni dhe në burg për ne, se kështu na kushtet mund të marrim pushtetin". Jo more!", - theksoi kreu i socialistëve. Ai

përsëriti edhe një herë se nuk mund të ketë ndarje të pushtetit dhe as dhënie të tij në tryezë opozitës. Vota theksoi kryeministri është përcaktuese për pushtetin në demokraci. "Noc Rrokun

### SHKRIRJA

"Ata zgjedhën të bëjnë diçka që askush nuk e ka bërë. Ka vetëm një parti që e ka bërë atë që bëjnë ata në vitet '20, në Itali. Edhe ajo parti që e bëri atë në vitet '20 në Itali u shkri fare. Ashtu do shkrihen dhe ata. Këtu do jeni. Ashtu do shkrihen dhe ata, sepse zgjedhën të tradhetojnë popullin e tyre, popullin që i votoi ata"



Kryeministri Edi Rama dhe sekretari i përgjithshëm i Partisë Socialiste, Taulant Balla, dje në Librazhd

### SHKURTE

#### Lojërat e fatit, kryeministri: Burg edhe për ata që luajnë 'online'

Të gjithë ata që do të luajnë online lojëra fati do të përballen me burgun. Pas nismës për të mbyllur lokalitetet e lojërave të fatit dhe dënimin e atyre që nuk e respektojnë ligjin, kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar ashpërsim të dënimeve edhe për ata që hapin llogari online për lojërat e fatit. Kryeministri Edi Rama tha sot se qeveria po punon për të ndërmarrë një reformë edhe në Kodin Penal me ashpërsimin e masave ndaj atyre që hapin llogari online për lojëra fati. "Online-in e ka problem e gjithë bota, edhe në Kinë ku është e ndaluar edhe në Amerikë. Ama sot ka ardhur koha të marrim disa masa. Disa masa të reja në Kodin Penal dhe ne po i përgatisim. Masa të reja të domosdoshme. Kush organizon bixhoz të shkojë në burg. Nuk ka më "jo po shko, kape, thirre, do bëhem çun i mirë, dil, vazhdo prapë". Kush organizon bixhoz për të tjerët, në një vend ku bixhozi është i ndaluar, të shkojë në burg", - theksoi Rama.

#### Rama pritet me protesta, disa banorë i bllokajnë rrugën

Kryeministri Edi Rama zhvilloi dje disa takime në Kozonë e Librazhdit ku u ndal edhe për turin "Bashkia që duam". Ashtu siç ka ndodhur thuajse në të gjitha takime e tjera, ai edhe në Librazhd është pritur me protesta të mbështetësve të opozitës. Disa nga banorët e zonës të udhëhequr nga strukturat e PD lokale kanë dalë në rrugë, duke tentuar që të mos lejojnë kalimin e kryeministrit. Por policia ka ndërhyrë duke hapur rrugën dhe rikthyer normalitetin në qarkullim. Ndërkohë që me pas policia e Librazhdit ka proceduar kreun e PD-së së këtij qyteti, Bujar Vreto si dhe 5 simpatizantë të selisë blu: Arben Kurtin, Roland Abazin, Xhevdet Balliu, Florant Vretin dhe Arjanit Lekën.

dhim", nuk ka. 30 vjet kjo histori duhet të marrë fund! Nuk na e keni dhënë mandatin ju që ne të shkojmë edhe të ulemi të shohim filxhan me Monën, se e sheh Mona në filxhan dhe i thotë Lulit, "e pashë Lul, edhe pak, po vjen". "Jepi Lul edhe pak, e pashë". "Pashë aty një "E" që po shkon poshtë, një "L" që po ngrihet, pashë një "T" këmbëpërpjetë, Taulantin,

prandaj, o burra Taulantit mbrapa", edhe Luli pas filxhanit", - tha më tej Rama. Kryeministri Edi Rama ka ftuar opozitën që të futet në zgjedhjet vendore të 30 qershorit dhe, nëse arrin që të fitojë qoftë edhe 1 bashki me shumë se socialistët, atëherë ai mazhoranca do jetë gati të pranohet zgjedhjet e parakohshme për të cilat proteston opozita.



Valentina Madani

Shkodra përkujtoi dhe katër dëshmorët e 2 prillit 1991. I pranishëm në ceremoni ishte dhe kreu demokrat Lulzim Basha, ku vendosi kurora me lule në Memorialin e Dëshmorëve të rënë më 2 prill. Basha apeloj se për Shqipërinë 2 prilli është kujtesë e përhershme që rrënjët e së keqes nuk thahen nëse nuk i shkulim njëherë e mirë. Në fjalën e mbajtur para të pranishmëve Basha deklaroi se 4 dëshmorët e Shkodrës do të qëndrojnë gjithmonë në kujtesën e shqiptarëve. Kreu demokrat bëri të qartë se protestat e opozitës do të kenë të njëjtin përfundim si sakrificat e 2 prillit me qëllim që, sipas tij, të rrëzojnë diktaturën e krimin. Lulzim Basha paralajmëroi se nuk do të ndalet nga beteja e nisur me qytetarët për votën e lirë. Futja në zgjedhje pa opozitën sipas tij është një përpjekje e Ramës për të likuiduar opozitën. Lideri i PD-së akuzoi se maxhoranca aktuale mendon se mund ta likuidojë opozitën, duke fituar Shkodrën pa zgjedhje. Por më tej Basha tha se s'ka gaz dhe makineri që do të mund ta shtypë opozitën. "Në delir nga aleanca e politikës me krimin, e krimin politik që vijon të përgjakë Shkodrën dhe të gjithë Shqipërinë, shëmbëlltyra e këtij regjimi mendon se mund ta likuidojë opozitën, se mund të bëjë edhe pa të, edhe se mund ta marrë Shkodrën edhe pa zgjedhje e mund ta mbajë Shqipërinë pa zgjedhje e nën zgjedhje, për sa kohë t'i nevojitet, mundësisht përjetësisht. Kjo nuk ka për të ndodhur. Nuk ka vegla të verbra, as gaz lotsjellës, as hafije, as aparat shtypës, që mund të rikthejë qetësinë e kufomës politike të "Rilindjes", trashëgimtare së denjë të krimin të 2 prillit të vitit 1991. Protesta madhështore e shkodranëve dhe e gjithë shqiptarëve ka vetëm një përfundim, të njëjtin përfundim që pati protesta e 2 prillit dhe sakrificat e 4 bijve më të mirë shkodranë, rrëzimin e diktaturës, triumfin e lirisë, triumfin e demokracisë", deklaroi z.Basha. Sipas kryedemokratit, 28 vite pas demonstratës antikomuniste ku mbeten të vrarë katër dëshmorët e demokra-

Kreu i PD nderon dëshmorët e 2 prillit: Shkodra e shkishëroi shitblerjen e votës

# 'S'ka zgjedhje pa opozitën', Basha: Duan të na likuidojnë

"S'ka gaz dhe makineri që mund ta shtypë opozitën"

**MUNGESA**

Në protestën e sotme të opozitës para Kuvendit, do të mungojë kreu i PD, Lulzim Basha, i cili ndodhet në Berlin ku do të takohet me zyrtarë të CDU-së dhe Partive Popullore Evropiane. Në qendër të takime është situata politike në Shqipëri dhe aksioni i opozitës për largimin e qeverisë "Rama". Edhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi ndodhet në Romë për të marrë pjesë në forumin "Dialoghi Me agrialimentare".



**PROPOZIMI I KOKËDHIMËS**

Partia Zgjidhja, me kryetar Koço Kokëdhima propozon një projekt-pakt kombëtar për të dalë nga situata aktuale politike. Ish-deputeti i PS propozon shtyrjen e zgjedhjeve vendore në 30 qershorit në muajin tetor. Ai kërkon që presidenti të zgjidhet nga populli, parlamenti të mos ketë më shumë se 100 deputetë si dhe, të zhbëhën ndryshimet kushtetuese të vitit 2008. "Për të kapërcyer krizën është akute, që vendi të dalë nga sistemi i partitokracisë, kërkohej çmontimi i pushtetit absolut të kryetarëve dhe rivendosja e republikës", tha z. Kokëdhima.




## Kryemadhi, Ramës: Gratë shqiptare s'janë si ato që përdor si struktura eskorte

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi akuzoi dhe kryeministrin Rama se gjatë fjalës së tij në Përrrenjas, poshtëroi kryetaren aktuale të Bashkisë, Miranda Rira. Në një reagim në "Facebook", Kryemadhi thekson se Rama guxoi të përflasë Rirën, që është bërë nënë për herë të dytë. Ajo e cilëson kryeministrin pervers, që sipas saj nuk ka respekt për gratë e vajzat në përgjithësi e as për ato që i shërbejnë. Kryemadhi e shikon deklaratën e Ramës si diçka që përdor për të tërhequr vëmendjen nga kriza. "Me perversitetin që e karakterizon, me pasionin për të poshtëruar gratë dhe vajzat që nuk i binden dëshirave dhe presionit të tij, Edi Rama ka guxuar paturpësisht të përflasë edhe Kryetaren e Bashkisë Përrrenjas, e cila sapo është bërë nënë për herë të dytë. Miranda Rira ka pak ditë që është bërë nënë, por as në fjalosjet më banale shqiptare, as në kohët më të vështira, si asnjëherë kryeministri ka përfolur një grua që sapo është bërë nënë. Kjo ndodh jo vetëm për mungesën e respektit që ai ka për gratë e vajzat në përgjithësi, as për ato që në veçanti i shërbejnë dhe nuk guxojnë t'i kthejnë fjalë, nuk ndodh as sepse ai përdor çdo gjë për të prodhuar lajm e për të tërhequr vëmendjen nga kriza", shprehet Kryemadhi. Sipas saj "e gjithë kjo përbuzje për gratë vjen prej formimit të tij, prej mënyrës si e ka ndërtuar jetën dhe karrierën ku gratë kanë qenë të keqpërdorura prej tij. Duke harruar se vajzat dhe gratë shqiptare nuk janë ato që Edi Rama mendon apo përdor si struktura eskorte, nuk janë ato që presin që jetën dhe karrierën tua ndërtojë ekipi i rilindjes". "Vajzat dhe gratë shqiptare janë dinjiteti i shoqërisë dhe forca e familjes. Janë ato që sot më shumë se kurrë e kuptojnë dhe luftojnë për një jetë më të mirë për veten dhe familjen dhe për më shumë dinjitet në një shoqëri të marrë peng nga qeverisja e bandave. Shqipëria shtëpia juaj!", tha zj.Kryemadhi.

## Nëna e Besnik Cekës: Ruçi do e lajë gjakun e 4 dëshmorëve

Mbetet një nga momentet më të vështira për ta në 28 vite, ku çdo 2 prill vendosin kurora me lule dhe ju bashkohen ceremonive përkujtimore në nderim të bijve të tyre, që dhanë jetën për demokracinë. Por bashkë me dhimbjen me ta bashkëjeton edhe zhgënjimi që në 28 vjet, kjo ngjarje nuk u zbardh asnjëherë dhe fajtorët nuk shkuan përpara drejtësisë. Dosja 2 prilli fle ende në arkivat e një drejtësie që nuk e ka thënë fjalën e saj. Familjarët e Nazmi Kryeziut dhe Besnik Cekës e dinë shkakтарin e kësaj tragjedie, që sipas tyre është Gramoz Ruçi. "Ne duam drejtësi. Drejtësia në Shqipëri as nuk është vënë as nuk do të vihet. Ne duam urdhërdhënës. Dihet kush i dha urdhër që të nxirren nga reparti ushtarak, tanket. Dihet kush është autori i vrasjes, Gramoz Ruçi, si ministër i Brendshëm në atë kohë. Edi Rama nuk e përmend një herë 2 prillin. Ata nuk kanë qenë zogj pëlumbash, por fëmijë nënash. Gramoz Ruçi të mos dalë më në parlament. Një autor vrasjesh të drejtëj parlamentin e dalë nga populli nuk është e drejtë. Ai është autor i vrasjes së 4 djemve tanë, dhe 70 të plagosur. Ai dikur do e lajë atë gjak, se gjaku nuk humb, por vlon", tha Maja Ceka, nëna e Besnik Cekës.



## PD: U përdor edhe SHISH për të fabrikuar dëshmitarin e rremë

Çlirim Gjata, sekretar për çështjet ligjore në Partinë Demokratike përmes një deklarate për mediat akuzoi dhe Kryeministri Rama dhe ish-ministri i Brendshëm Xhafaj kanë përdorur policinë, shërbimin sekret dhe prokurorinë për të mbuluar të vërtetën e dosjes "Babale", e vërtetë kjo që u faktua nga përgjimet e publikuara së fundi nga deputeti Salianji, siç tha Xhafaj. Sipas tij, fabrikimi i dëshmitarit të sajuar është radiografia e narkoshtetit që mbulon të vërtetën e vëllait trafikant droge të ministrit të Brendshëm për të goditur opozitën.

cisë Arben Broci, Bujar Bishanaku, Nazmi Kryeziu dhe Besnik Ceka, Shqipëria e 2019 është e ngjashme me të diktaturës. "Sot Shkodrës dhe mbarë Shqipërisë ia merr ajrin një shartese, një mostër sa politike aq dhe kriminale, e cila është rritur nga mungesa e vëmendjes, nga pandëshkueshmëria, nga indiferenca dhe tolerimi. Kjo mostër është qeverisja me krimin që mbijeton edhe për shkak se nuk i nxorrem siç duhet përgjegjësitë e 2 Prillit 1991. 2 prilli si bashkëjetese e krimin me qeverinë ka sot fytyrën e krerëve të qeverisë dhe të parla-

mentit", -u shpreh kreu i PD-së. Lulzim Basha përmendi se Shkodra e ka shkishëruar shitblerjen e votës, ndaj i ftoi shqiptarët të bashkohen në këtë shembull në betejën për demokraci, zgjedhje të lira e të ndershme dhe shtet ligjor. "2 prilli hyri në historinë tonë kombëtare dhe asnjëherë nuk do të reshtim së kujtuari këtë kujtesë të përhershme se rrënjët e të keqes nuk thahen nëse nuk i shkulim njëherë e mirë. Rrënjët e të keqes ushqehen me vesin dhe me krimin e pandëshkuar. 2 prilli si bashkëjetese e krimin dhe qeverinë, ka fytyrën e krimin dhe par-

## NEGOCIATAT INTEGRIMI

Komisioneri për zgjerimin: Janë përmbushur kriteret, duhet të reagojmë pozitivisht

# Negociatat, Hahn: Tashmë është koha, rekomandim pozitiv për Shqipërinë

Raporti pritet të publikohet në 29 maj

Valentina Madani

Komisioni European është i vendosur të paraqesë një rekomandim pozitiv për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë në raportin që pritet të publikohet në 29 maj. Komisioneri për zgjerimin, Johannes Hahn, i tha dje Komitetit të Punëve të Jashtme të Parlamentit European, se hapja e negociatave me partnerët që i kanë përmbushur kushtet lidhet me besueshmërinë e BE-së. "Ne në Komisionin European do të prezantojmë raportin tonë vjetor lidhur me vlerësimin e reformave të vendeve të Ballkanit dhe Turqisë në fund të majit. Ne do të bëjmë një rekomandim për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut, por edhe Shqipërinë. Kjo do bëhet zyrtarisht, veçanërisht në vijim të hapave që ka bërë Maqedonia e Veriut. Mendoj se është tashmë vërtetë koha për këtë. Një vit më parë patëm një qëndrim pozitiv të 25 deri në 26 shtete anëtare për këtë. Çështja e emrit u zgjidh dhe tani mendoj se duhet të hedhim hapin e ardhshëm", deklaroi Johannes Hahn, komisioneri për zgjerimin. Z.Hahn komentoi dhe protestat në disa vende të rajonit, duke kundërshtuar shprehjen "Pranvera e Ballkanit". Duke iu përgjigjur pyetjeve të eurodeputetëve, Hahn ka bërë dallimin midis protestave në Ballkanin Perëndimor, duke kundërshtuar termin "Pranvera e Ballkanit". Ai siguroi skeptikët e zgjerimit se procesi i paraanëtarësimit i nënshtrohet unanimitetit të shteteve anëtare të Bashkimit European. "Unë nuk do të përdorja termin 'Pranvera e Ballkanit', pasi protestat në Serbi, Mal të Zi dhe Shqipëri bëhen për arsye dhe motive të ndryshme. Ka shumë çështje të politikës së brendshme që lidhen me këto protesta dhe vijnë si rrjedhim i pakënaqësisë kundrejt qeverive aktuale. Unë dua të shoh shumë pozitivisht hapjen e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut, por rrjedhimisht edhe me Shqipërinë.



Komisioneri për zgjerimin, Johannes Hahn

### SUGJERIMI

"Ne në Komisionin European do të prezantojmë raportin tonë vjetor lidhur me vlerësimin e reformave të vendeve të Ballkanit dhe Turqisë në fund të majit. Ne do të bëjmë një rekomandim për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut, por edhe Shqipërinë. Kjo do bëhet zyrtarisht, veçanërisht në vijim të hapave që ka bërë Maqedonia e Veriut. Mendoj se është tashmë vërtetë koha për këtë", tha Z.Hahn.

## "SHBA mbështet institucionet e reja të drejtësisë"

### Ndjekjet penale, Moses Ones: Presim më shumë nga prokuroria

Ngarkuara me punë e Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë, Leyla Moses Ones, vlerësoi dje hapat që janë bërë për reformën në drejtësi. Zyrtarja amerikane kërkoi më shumë heqime nga prokuroria dhe në të njëjtën kohë tregoi mbështetjen e SHBA-ve për institucionet e reja që po krijohen. Ajo përmendi se SHBA-të presin më shumë sa u takon ndjekjeve penale. "Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të sjellë së shpejti prokurorët e SPAK dhe më pas Byronë Kombëtare të Hetimit. Prokurorët të Departamentit Amerikan të Drejtësisë po këshillojnë prokurorët shqiptarë, të cilët tashmë po sjellin ndjekje penale të dukshme dhe ne presim më shumë", theksoi zj.Leyla Moses Ones. E Ngarkuara me punë në ambasadën ameri-



kane në Tiranë nënvizoi se SHBA-të do të vazhdojnë të mbështesin të gjitha institucionet e reja shqiptare, si këshillat dhe SPAK si dhe institucionet ekzistuese që janë të dedikuara për të luftuar krimin dhe korrupsionin. "Reforma në drejtësi ka ecur përpara dhe nuk do të ndalet. Zyrtarë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë duke asistuar në ngritjen e SPAK. Për ne është e rëndësishme të kemi një Shqipëri të zhvilluar, që ecën në rrugën e integritit

euro-atlantik. Ndiheja jonë do të vazhdojë për Këshillin e Lartë Gjyqësor, atë të Prokurorisë dhe SPAK. SHBA-të po këshillojnë nga afër prokurorët shqiptarë dhe po sjellin ndjekje të dukshme të çështjeve penale. SHBA-të mbështesin të gjitha institucionet e reja të drejtësisë, si SPAK-u, por më e rëndësishmja është që reforma në drejtësi po ecën përpara dhe nuk do të ndalet", - tha zj.Ones. Deklaratat e të ngarkuarës me punë e Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë, Leyla Moses Ones u bënë dje në Ministrinë e Brendshme, ku u zhvillua event për "Menaxhimin e Brendshëm, ku u zhvillua event për "Menaxhimin e Brendshëm, Sandër Lleshaj, e cilësioi projektin për modernizimin e policisë si një hap të rëndësishëm të policisë në luftën kundër krimin.

Secili bëhet nervoz për këtë, por kjo nuk do të thotë gjë tjetër, përveçse që ne do të mund të fillojmë përgatitjet për hapjen e kapitujve të parë të negociatave. Dhe për këtë kërkohet vendim unanim i të

gjitha shteteve anëtare. Pra, vlerësimi i përmbushjes së kriterëve kërkon një vendim unanim. Por, mesazhi ynë duhet të jetë nga ana tjetër, se nëse partnerët tanë përmbushin kriteret për hapjen e

negociatave, edhe ne duhet të reagojmë pozitivisht", - u shpreh z.Johannes Hahn. Komisioneri për zgjerimin qëtesoi skeptikët e zgjerimit të Bashkimit European me shtetet e Ballkanit, duke



## Presidentja e "EPP Women": Ndjehem e turpëruar

### Doris Pack: Ambasadorët mbyllin sytë për situatën në Shqipëri

Në takimin e grave politike që i përkasin grupimit më të madh politik europian, Partisë Popullore Europiane, Presidentja e "EPP Women", Doris Pack mbështeti vendimin e Partisë Demokratike për dorëzimin e mandateve si një përpjekje për kushtetutshmëri, vlera e standarde europiane. "E përshëndes dhe e mirëkuptoj këtë vendim të marrë në kushtet e shkeljes së të drejtave kushtetuese edhe të opozitës, në mungesë të gjykatës kushtetuese, në mungesë të mundësisë së apelimit të çdo lloj vendimi, sepse gjykatat nuk funksionojnë", - tha Doris Pack. Presidentja e EPP u kërkoi anëtarëve të "EPP Women", që informacionin për Shqipërinë ta çonin edhe në kancelaritë e vendeve të tyre. "Kjo është e rëndësishme, sepse ambasadorët e vendeve të BE-së dhe përfaqësuesit e Parlamentit European po mbyllin sytë përballë një situatë tejet problematike dhe të pashpresë, e cila ka ndikuar edhe për rritjen e numrit të emigrantëve nga Shqipëria në vendet tona. Kjo nuk është çështje e një partie në Shqipëri, por është çështje e të drejtave të njeriut, të qytetarëve që janë krejtësisht të neglizhuar nga qeveria e Ramës. Ndaj, ju lutem merrni këtë informacion dhe në mënyrë që çdo kush të kuptojë çfarë ndodh në Shqipëri", - tha Doris Pack, e cila theksoi se ndjehet e turpëruar nga ambasadorët, që heshtin dhe nuk përcjellin informacionin në Ministrinë e tyre të Jashtme, e nuk flasin për realitetin në Shqipëri. Presidentja e "EPP Women" citoi Departamentin e Shtetit për të treguar se krimi i organizuar është forcuar edhe më shumë këtë vit në Shqipëri, duke e kthyer vendin në një vend transit për kokainën dhe heroinën që shpërndahet në vendet europiane.



thënë se për Kroacinë janë dashur 8 vjet negociata. Sipas Hahn, negociatat me vendet kandidatë aktuale do marrin më shumë kohë. "Nëse partnerët tanë i kanë plotësuar kushtet, është detyrë jonë për të përmbushur angazhimin tonë dhe për t'i hapur negociatat. Hapja e negociatave kërkon votën

uanime të të gjithë anëtarëve", theksoi komisioneri Hahn. Ai vlerësoi se BE-ja ka partnerët të shkëlqyer në Ballkanin Perëndimor. Johannes Hahn foli edhe për problemet në rajon, sidomos bllokimi i bisedimeve mes Prishtinës dhe Beogradit dhe ka shprehur për tejkalimin e ngërçit.



Raporti, cili është funksionari i lartë që pastron paratë e korrupsionit në ndërtim?

# Korrupsioni i zyrtarëve, 5 mënyrat si i pastrojnë paratë e pista

*Lëndët narkotike dhe korrupsioni, burimet kryesore të lekëve*

Funksionari publik "G" në vitin 2018 lidhi një kontratë për blerje të një pasurie të paluajtshme në vlerë prej 130,000 euro. Kjo vlerë investimi, që nuk justifikohet nga të ardhurat e tij si funksionar publik, shërbeu si shkak për të investuar më tej lidhur me burimin e të ardhurave të tij nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Kjo në fakt është një rast për të ilustruar një nga skemat më të thjeshta që raporton DPPP, që përdorin kryesisht zyrtarët dhe funksionarët shtetërorë për të pastruar paratë, që i marrin nëpërmjet korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës. Sipas kësaj drejtorie, në total për vitin 2018 janë 5 tipologji kryesore të përdorura më shumë nga shtetasit për pastrimin e parave në vendin tonë. Sipas kësaj drejtorie, nga verifikimet e kryera për rastin e parë rezultoi se familjarët e këtij shtetasi kanë kryer dy investime të tjera në pasuri të paluajtshme dhe sende luksi, përsëri në vlera të konsiderueshme në total 205,000 euro. Në emër të tij është regjistruar një biznes, por fitimet nga ky aktivitet rezultuan të jenë të papërfillshme, krahasuar me investimet e kryera prej tij dhe familjarëve të tij. Ndërkohë që përveç kontratës së sipërcituar, ai rezultoi të ketë lidhur edhe 6 kontrata notoriale, ndër të cilat evidentohen investime të tjera në pasuri të paluajtshme. Vërehen edhe 3 kontrata huaje të lidhura prej tij, sipas të cilave ka marrë hua nga disa persona (shtetasit P) dhe anëtarë të familjes së tij, të cilat përdoren edhe si justifikim për burimin e fondeve, por këta persona nuk kanë kapacitet ekonomik për gjenerimin e fondeve të tilla. Siç deklaroi kjo drejtori në raportin e saj vjetor për 2018-ën, rasti i funksionarit të mësipërm tashmë ka nisur një proces penal për veprën penale "Shpërdorim detyrë".



lëndëve narkotike. **TIPOLOGJI 3**

Tipologjia 3 kanë të bëjnë me qarkullim e shumave të dyshimta në sistemin bankar. Për këtë, DPPP sjell rastin e shtetasit A, që zotëron llogari personale në një bankë të nivelit të dytë, në disa monedha. Ky individ vihet re të jetë shumë aktiv dhe në llogaritë e hapura në emër të fëmijëve të tij të mitur. Përgjatë një periudhe disavjeçare ka kredituar në llogaritë e tij në vlera të larta (mbi 1 milion euro). Sipas të dhënave të deklaruara në bankë, shtetasi ushtron një profesion që nuk justifikon akumulimin e këtyre fondeve. Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se shtetasi A rezultoi të ketë nënshkruar ndër vite, rreth 45 akte notoriale për shitblerje pasurish të paluajtshme, në të cilat kryesisht figuron në cilësinë e palës blerëse/porositëse. Ndërkohë që vlera e pasurive të paluajtshme të blera prej tij rezultoi të jetë rreth 1.5 milion euro. Gjithashtu, shtetasi A rezultoi gjithashtu të ketë dhe disa raportime të kontratave për dhënie hua në vlera të konsiderueshme monetare. Për këtë, kjo drejtori dyshon se ai ushtron aktivitetin e shitblerjes së makinave dhe huadhënie me interesa të larta.

**TIPOLOGJIA 4**

Topologjia 4 gjithashtu trajton rastin e shoqërisë A me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin e huaj I. Në vitin 2017 kjo shoqëri ka përfutur një transferim të vlerë 3 milionë euro nga shoqëria e huaj B. Shoqëria A për të justifikuar këtë transferim të huaj B, e cila përfaqësohet nga shtetasi i huaj Z. Nga verifikimet e kryera rezultoi se shoqëria A brenda një periudhe të shkurtër kohore, ka transferuar një pjesë të konsiderueshme të fondeve të përfutura drejt shoqërive të ndryshme të huaja në Evropë dhe Azi, nga të cilat evidentohet se, shuma më e lartë (1 mln euro) është dërguar nëpërmjet disa transferimeve në favor të shoqërisë së huaj C në Evropë. Ndërkohë, në lidhje me shtetasin e huaj Z rezultoi se ka të dhëna për precedent penal për veprën penale "mashttrim". Ndërkohë që tipologjia 5 trajton transferat të dyshimta të përfutura nga shoqëri që veprojnë në fushën e "call center" nga shoqëri me seli në vend "off-shore".

**VERIFIKIMI**

Nga verifikimet e kryera rezultoi se shoqëria A brenda një periudhe të shkurtër kohore ka transferuar një pjesë të konsiderueshme të fondeve të përfutura drejt shoqërive të ndryshme të huaja në Evropë dhe Azi, nga të cilat evidentohet se shuma më e lartë (1 mln euro) është dërguar nëpërmjet disa transferimeve në favor të shoqërisë së huaj C në Evropë.



**Raporti, 1525 transaksione të dyshimta, 9,5 mln euro të sekuestruara**

Shqipëria vijon të mbetet një nga vendet më të preferuara të shtetasve shqiptarë dhe të huaj për pastrimin e parave. Drejtorja e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ka raportuar se në vitin 2018 kanë qenë plot 1,525 raportime për transaksione financiare dhe pasuri të paluajtshme të dyshimta, ose thënë ndryshe 10.2% më shumë krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë që 376 raste prej tyre i ka referuar në organet ligjzbatuese (343 në Policinë e Shtetit dhe 33 në Prokurori) për hetime më të specializuara. Ndërkohë që gjatë 2018-ës, kjo drejtori ka nxjerrë 24 urdhra bllokimi të përkohshëm, kryesisht për llogari bankare, në një vlerë totale prej rreth 5,4 milionë euro, nga të cilat janë sekuestruar me vendim gjykatë rreth 4,5 milionë euro. Në bazë të indicieve të dërguara nga DPPP në funksion të gjurmimit të aseteve të dyshuara me prejardhje kriminale, nga të dhënat e raportuara nga DPPSH rezultoi se janë sekuestruar edhe rreth 5 milionë euro pasuri të paluajtshme, duke e çuar në total vlerën e aseteve të sekuestruara me indicie nga DPPP në 9,5 milionë euro. Gjithashtu, rezultoi se gjatë vitit 2018, autoritetit tatimore në bazë të informacioneve të dërguara nga DPPP kanë rikuperuar në mënyrë të pavarur nga hetimet në fushën penale edhe rreth 34.4 milionë lekë, si dhe kanë në proces 17 raste për vlerësim tatimor, ku vlera e dyshuar si e deklaruar është rreth 482 milionë lekë.

siderueshëm transferatash (si dërgues dhe përfutës), për një periudhë 4-vjeçare, në vlera që variojnë nga 20 deri në 1.200 euro, por kryesisht mbizotërojnë transferat në vlerat nga 200- 600 euro me shtetas të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj dhe me shtete të ndryshme. Shtetasi Z, gjatë një periudhe 2-vjeçare ka dërguar dhe përfutur disa transferata në vlerat nga 30 deri në 1.000 euro. Nga verifikimet të mëte-

jshme ka rezultuar se shtetasi Z merret me shitblerje të monedhave virtuale dhe se ka lidhje me aktivitetin e subjektit që zotëron shtetasi X. Nga verifikimet e kryera, rezultoi se shtetasi X dhe Y zotërojnë 2 subjekte tregtare, një ndër të cilat ka objekt veprimtarie të deklaruar si të lidhur me kriptomonedha. Më tej rezultoi edhe se shtetasi X ishte arrestuar nga Policia, si person i lidhur me trafikun e

**Masat administrative për subjektet, 14 mln lekë gjoba**

Gjatë vitit 2018 janë evidentuar subjekte që nuk përmbushin nivelin e duhur të përputhshmërisë me kuadrin rregullator, për të cilat ka vijuar procesi i shqyrtimit të kundërvajtjes administrative deri në dhënie e dënimit me gjobë sipas dispozitave përkatëse.

Përveç inspektimeve në vend, janë vlerësuar dhe praktika të mbikëqyrjes në distancë nëpërmjet Raporteve të Vetëkontrollit apo indicie nga monitorimi në distancë i subjekteve për shkelje të detyrimeve ligjore. Minimumi i gjobës së aplikuar ka qenë 300 000 lekë dhe maksimumi 4 000 000 lekë. Vlera totale e gjobave të vendosura është 14 200 000 lekë. Peshën kryesore nga subjektet e gjobitura e zënë shoqëritë e ndërtimit, ndaj të cilave janë aplikuar 10 masa me vlerë 9.8 milionë lekë, të ndjekura nga noterët, ndaj të cilave u aplikuan 4 masa me vlerë totale 2.8 milionë lekë. Masat administrative të konstatuara në raport me inspektimet e kryera kanë pësuar ulje, element ky përgjithësisht tregues i rritjes së masave të sistemit parandalues në vend.



Banka Botërore parashikon ngadalësim të rritjes ekonomike në 3 vitet e ardhshme


# BB: Pasiguria politike rrezik për ekonominë, dëmton klimën për bizneset

## Kujdes PPP-të, pavarësisht uljes së borxhit publik

**E**konomia shqiptare është e ekspozuar kundrejt disa rreziqeve gjatë vitit 2019 e në vijim. Rreziqet nga PPP-të, pasiguria politike në zbatimin e reformave strukturore do të sjellin vetëm ritme të ulta rritjeje, por edhe mund të dëmtojnë si klimën e biznesit ashtu edhe perspektivën e anëtarësimit në BE. Të dhënat u publikuan në raportin e Bankës Botërore, e cila parashikon një rritje ekonomike më të ngadalët sesa në vitin 2018 në tre vitet e ardhshme. Në raportin e fundit Banka Botërore parashikon që shtesa në tre vitet e ardhshme do të shkojë deri në 3.8 për qind.

### KRIZA POLITIKE

Kriza politike shihet si një rrezik për investimet e huaja pasi dëmton klimën e të bërit biznes. Gjatë prezantimit të raportit ekonomik rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor, Hilda Shijaku, ekonomiste pranë BB-së në Shqipëri tha se risqet fiskale vijnë në të jenë prezente. "Në tre vitet e ardhshme ekonomia e Shqipërisë mendojmë se do rritet më ngadalë sesa në vitin 2018 për disa faktorë. E para, ritmi i rritjes potenciale do të jetë ai që do tërheqë rritjen ekonomike. Faktorët e përkohshëm që janë vënë re në vitin 2018 dhe në disa nga vitet më përpara mendojmë se nuk do jenë të pranishëm, megjithatë kjo rritje ekonomike shoqërohet nga rreziqet të jashtme dhe të brendshme. Ndër rreziqet e jashtme mund të përmendim luftën tregtare dhe mar-



rëveshjet gjeopolitike, të cilat mund të dobësojnë lidhjen ekonomike mes vendeve, sidomos me vendet partnere. Një tjetër faktor është një rritje më ngadalë në rritjen ekonomike të vendeve të BE, sidomos Italisë, e cila regjistroi recension së fundmi. Gjithashtu, kushtet më pak të favorshme të huamarrjes, që do rrisinin koston e huamarrjes për Shqipërinë, pasi është e ekspozuar ndjeshëm ndaj huamarrjes së huaj. Mund të faktorizohet si një nga rreziqet e jashtme. Ndër rreziqet e brendshme mund të përmendim faktorët klimaterikë, që mund të gjenerojnë si në Shqipëri ashtu edhe në gjithë vendet e Ballkanit,

momente pozitive për rritjen ekonomike por mund të ketë edhe vite në të cilat këto kryejnë dëme të mëdha. Një tjetër dobësi e brendshme është sektori financiar, i cili ende vazhdon të vuajë nga një diversifikim i ulët si edhe nga një kreditim i moderuar. Nga pikëpamja fiskale unë përmenda pak më parë rreziqet që vijnë nga aktivitetet jashtë bilancit, të cilat nëse nuk menaxhohen në mënyrën e duhur mund të ezaurojnë hapësirat fiskale për politika të mëtejshme dhe mund të cenojnë konsolidimin fiskal. Së fundmi, pasiguria politike dhe vonesa në zbatimin e reformave strukturore mund të dëmtojnë, si klimën e biznes-

it, ashtu edhe perspektivën e anëtarësimit në BE." -tha Hilda Shijaku. Pasiguri politike- Pasiguria politike është një nga faktorët që ky raport përmend si një nga faktorët me mundësi ndikimi në klimën e biznesit. "Sugjerim që bën ky raport lidhet me faktin se këto protesta që vihen re në shumë vende të

Ballkanit lidhen edhe me reformave strukturore. Në rastet kur lidhen me një pasiguri ekonomike, apo kushte të vështira ekonomike me një pasiguri për të ardhmen autoritetet e këtyre vendeve duhet të marrin masa për të përshpejtuar reformat strukturore në drejtimin që unë përmenda duke lehtësuar mundësimin në integrimin e tregut të punës përmes investimit të kapitalit human duke përmirësuar klimën e biznesit dhe duke krijuar kushte të barabarta zhvillimi për të gjithë", -tha Hilda Shijaku.

### PPP-TË

Pavarësisht uljes së borxhit publik Banka Botërore thekson se duhet të bëhet kujdes nga efektet e PPP-ve. "Rreziqet fiskale janë të pranishme dhe lidhen kryesisht me aktivitetet jashtë

bilancit ku përfshihen Partneritetet Publike Private dhe detyrimet që mund të akumulohen në marrëjtet publike", -tha Shijaku. Kriza energjetike- Banka Botërore i bën thirrje qeverisë që të gjejë mekanizma për të përballuar krizën energjetike. Vetëm në muajt e parë të vitit për të mbuluar nevojat e vendit me energji janë importuar rreth 100 mln euro ndërkohë që hidrocentralet janë në pikën e vdekjes. Sipas Bankës Botërore qeveria nuk duhet thjeshtë të shikojë nëse ka fond në buxhet për vitin korent për të mbyllur nevojat për energji, por duhet dhe të krijojë mekanizma që të sigurojnë qëndrueshmëri në sektorin energjetik". Për të përmirësuar situatën ekonomike Banka Botërore sugjeron që të vijnë reformat strukturore.

### Kuvendi detyron 'Konkurrencën'

## "Llogarit dëmet e koncesioneve për konsumatorët"



likimit të librit, tregun farmaceutik, tregun spitalor, tregun e ofrimit të arsimit të lartë, tregun e shërbimit të profesioneve të lira, si dhe mbrojtjen e të dhënave dhe konkurrencën. Lajmi konfirmohet nga vetë Autoriteti

i Konkurrencës, në raportin e vitit 2018, dorëzuar së fundmi në Kuvend. Sipas këtij raporti, mbikëqyrja dhe hetimi i këtyre tregjeve gjatë këtij viti do të jetë dhe një nga prioritetet kryesore të këtij institucioni.

### NJOFTIM PUNESIMI

Mundësi punësimi, PËRKTHYES TURQISHT. Adresa: Pashaliman, Orikum. Shtabi i Ekipit në Shqipëri kërkon të punësojë me kontratë përkthyes Turqisht. Nr i kontaktit: Cel:0676525266.



### OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION

#### 1. GENERAL CONDITIONS

- Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1
- Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in economic development, legal reform, vocational education and training, reform of the water sector, rural development, reforms on strengthening of the internal security, and other areas.
- Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified companies to express their interest in providing office furniture's such as table, chairs, bookcase, etc.

#### 1 Companies should fulfil the following requirements:

- The products should be 'brand name' and the company should be an authorized partner for Albania from manufacturer, for selling and supporting the brand(s) products they offer.
- The company should be an authorized service provider for the products it will offer.
- The economic operator must submit evidence of the official test results issued by authorized institutions certifying the compliance of the products with the technical specifications
- The company participating must have the Manufacturer's ISO 14001 certificate.
- The ecological panel of the manufacturer realized 100% wood after consumption.
- Certificate of OHSAS 18001 manufacturer for design, manufacture and assembly of office furniture.
- Manufacturer iso 9001 certificate for design, installation and fitting of the offices
- The firm that will participate in the race, has the manufacturer's authorization.

All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de

- The due date for submitting the application is 8<sup>th</sup> of April 2019. The application, and any related documents if applicable, should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Procurement of respective equipment for the project "Sustainable Development of Rural Areas", addressed to:

German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1 Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

**M**inistria e Financave ka dorëzuar në Kuvend një projektligj për rregullimin e sektorit të hidrokarbureve. Ndryshimet kryesore janë mbështetur në katër shtylla kryesore. E para, drafti synon që të sqarojë regjimin fiskal për operacionet hidrokarbure; e dyta, të qartësojë çështjet e shumta që shkaktojnë vështirësi në praktikë dhe të promovojë gjerësisht transparencën; e treta, të ndërtojë një ndërlidhje ndërmjet marrëveshjeve dhe ligjit ekzistues të taksave dhe e fundit të japë një qartësi më të madhe përsa i përket roleve përkatës në administrimin e regjimit fiskal, si dhe me çështjet e ngritura lidhur me shpërndarjen e përgjegjësisve administrative për

**Drafti "për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur"**

**Ndryshon ligji për hidrokarburet, preken taksat**

**DRAFTI**

Drafti është hartuar nëpërmjet një grupi asistencë teknike nga departamenti i çështjeve fiskale në FMN, në qershor 2018 dhe u arrit në një vlerësim teknik dhe krahasues të regjimit aktual fiskal.

regjimin. Drafti është hartuar nëpërmjet një grupi asistencë teknike nga departamenti i çështjeve fiskale në FMN në qershor 2018 dhe u arrit në një vlerësim teknik dhe krahasues të regjimit aktual fiskal. Ky grup vlerësoi regjimin, veçanërisht në drejtim të sigurimit të për-

fitimit më të madh për vendin nga burimet e veta hidrokarbure, pa dekuruar investimet në sektor. Ai identifikoi natyrën hibride të regjimit dhe vështirësi të shumta me të. "Projektligji është strukturuar me fokus adresimin e çështjeve me regjimin ekzistues, speci-

fikimin me qartësi të regjimit fiskal për operacionet hidrokarbure dhe ndërlidhjen e tij me regjimin rregullator (bazuar në ligjin për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi) i 1993, "ligji i sektorit"). Për të mbështetur qartësinë, renta e hidrokarbureve trajtohet në projektligj, duke u zhvendosur nga ligji i taksave kombëtare", - thuhet në relacionin që shqyrtë draftin. Ky projektligj fokusohet në "operacionet hidrokarbure", siç përcaktohet nga ligji i sektorit. Personat që kryejnë operacionet hidrokarbure janë të



autorizuar nga marrëveshje për nxjerrjen e hidrokarbureve shqiptare dhe regjimi fiskal është çmimi që ata paguajnë për këtë të drejtë. Një çështje veçanërisht e vështirë është e drejta e kontraktorëve për të përdorur persona të tjerë për nxjer-

rjen e naftës shqiptare, dmth., përdorimi i nënkontraktorëve. Me lidhjen e një marrëveshjeje hidrokarbure me një person të caktuar, regjimi rregullator nënkupton që ai person do të kryejë operacionet hidrokarbure.

Drejtori i Mbikëqyrjes së Tregjeve në AMF, Endri Kote: Ja si do të llogariten pagesat

**"Shoferët e mirë" do paguajnë më pak për siguracionin e makinave**

*Nëse keni disa aksidente brenda vitit, do të paguani dyfish*

**N**ga e hëna nisi mbajtja e historikut të aksidenteve automobilistike. Drejtuesit e automjeteve që në një vit kalendarik nuk përfshihen në asnjë aksident do të përfitojnë 5% ulje për tarifën e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve, ndërsa ata që përfshihen në aksidente, do të paguajnë policën 15% më shumë. Kjo është në vijë të përgjithshme, skema që do të ndiqet për sigurimin e detyrueshëm të automjeteve me hyrjen në fuqi të sistemit "bonus malus". Drejtor i Mbikëqyrjes së Tregjeve në AMF, Endri Kote, shprehet se historiku i aksidenteve ka bazë vjetore dhe çmimet e siguracioneve do të vendosen me bazë të kësaj metodologjia nga prilli i 2020. "Mbas një viti, me shkaktimin e një aksidenti do të ketë një rritje me 15% të çmimit të policës dhe një ulje me 5% për ata drejtues që nuk kanë shkaktuar asnjë aksident", tha Endri Kote, drejtor i Mbikëqyrjes së Tregjeve, AMF. Në bazë të kësaj formule, për një automjet me një motor prej 1600 kubikë, çmimi bazë i sigurimit është afro 18 mijë lekë në vit, nëse kryhen një aksident çmimi rritet në 20,700 lekë. Kur je disa herë shkakhtar, çmimi mund të dyfishohet duke shkuar deri në 36 mijë lekë. Gjithsej janë 19 klasa ku listohen përdoruesit e autoveturave dhe mikrobusëve. Secili e nis nga klasa e trembëdhjetë, ka është përcaktuar tarifa bazë. Ndërkohë nëse nuk je shkakhtar aksidenti, mund të përfitojë deri në përgjysmim të tarifës. Përveç efektit ekonomik, AMF synon që të ulë numrin e aksidenteve dhe pasojave prej tyre me aplikimin e sistemit "bonus malus".



Drejtor i Mbikëqyrjes së Tregjeve në AMF, Endri Kote

thotë Kote. Nëse je shkakhtar i një aksidenti, atëherë çmimi i policës së sigurimit të detyrueshëm do të rritet dhe e kundërta ndodh nëse nuk shkakton aksident. "Ka efekte sociale mjaft pozitive, pasi scic është konstatuar edhe në vendet e zhvilluar evropiane në të cilat është aplikuar, ka sjelle një ulje të aksidenteve, pra duket rritur ndërgjegjësimin e publikut në drejtimin e automjetit së pasojave sociale në kujdes-

in e shëndetit të drejtuesve të automjetit dhe personave të tretë", tha Endri Kote, drejtor i Mbikëqyrjes së Tregjeve, AMF në një intervistë për "TCH". Akses në bazën e të dhënave të AMF me historikun e aksidenteve kanë të gjitha kompanitë e sigurimeve në vend. Nga ana tjetër, nga sistemi "bonus malus" janë të përjashtuar drejtuesit e motoçikletave, autobusëve, kamionëve dhe makinerive bujqësore.

**SIGURIMI "BONUS MALUS"**

Nga prilli i këtij viti nis mbajtja e historikut të aksidenteve automobilistike në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe pas një viti, çdo sigurim për autoveturat dhe mikrobusëve do të bëhet duke aplikuar sistemin "bonus malus". Udhëzimi i miratuar nga AMF përcakton kriteret për llogaritjen e skemës universale të sistemit "bonus-malus", që do të zbatohet nga të gjitha shoqëritë e sigurimit që ofrojnë produktin TPL e brendshme në kategoritë B1 (autovetura) dhe B2 (furgona, mikrobusë). Udhëzimi i miratuar nga Bordi i Autoritetit në pritje të ndryshimeve të plotë ligjore, me qëllim kryesor mbrojtjen e konsumatorit dhe përfshirjen e praktikave të njohura evropiane edhe në tregun shqiptar të sigurimeve. Kjo, pasi është verifikuar që në vendet ku është zbatim sistemi "bonus-malus" ka dhënë efekte në uljen e numrit të aksidenteve, mbrojtjen e jetës së qytetarëve dhe garantimin e një çmimi më të drejtë në

poliçat e sigurimit TPL. Në aspektin social, me aplikimin e sistemit "bonus-malus synohet ndërgjegjësimi i publikut për një drejtim sa më të kujdesshëm të automjetit, por edhe rritje e cilësisë së shërbimit të sigurimeve kundrejt konsumatorëve. Nga ana teknike procesi është më transparent dhe përfshirja e formulave matematikore e bën një mekanizëm të drejtë, të besueshëm dhe sipas meritës. Sistemi "bonus-malus" është mekanizmi i tarifimit në sigurimin e detyrueshëm MTPL, ku primi i zbatuar është i varur nga historiku i dëmeve/eksperiencia e drejtimit të automjetit nga ana e të siguruarit. Ky sistem penalizon ekonomikisht, me rritjen e primimit (deri në dyfishimin e tij), të siguruarin përgjegjës për një ose më shumë aksidente të shkaktuara/raportuara gjatë periudhës së sigurimit. Në anën tjetër, e favorizon atë me ulje të çmimit të primimit të sigurimit (deri në përgjysmim), nëse gjatë periudhës së konsideruar nuk ka shkaktuar asnjë dëm.

**MBYLLJA E GURORËVE**



**Ndërprietet aktiviteti i 12 gurorëve dhe 26 furrave gëlqerore në Krujë**

Vijon aksioni i mbylljes së aktivitetit të gurorëve dhe mbrojtja e shpallura të mblyllur 12 gurorëve dhe 26 furrave gëlqerore. Gjatë aksionit ishte pranishëm edhe ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, i cili u ka bërë të qartë pronareshëve të gurorëve të aplikojnë për leje në Ministrinë e Energjetikës për t'u vendosur në një vend tjetër.

**Nga ana e Shoqërisë "Sherbimi Permarimorë AB" Shpk është shpallur ankandi faza e dyte për pasurinë e mëposhtme:**

1-"Apartament" me sipërfaqe totale 125 m<sup>2</sup> me Nr. pasurisë 4/63+1-42 në Zonën Kadastrale 8602 Volumi 16 Faqe 109 e ndodhur në Vlorë. Çmimi fillestar për shitjen në ankand të pasurisë është 38,528 (tridhjetë e tete mijë e pesëqind e njetë e teta) Euro.

Ankandi do të zhvillohet në datë 19.04.2019 në orën 16:00 pranë zyrës së shoqërisë "Sherbimi Permarimorë AB" Shpk me Përmbarues Gjyqësor Privat Admir Beqiri të ndodhur në adresën Rr.Bul Zhan Dark Palli,Kulla.1Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane.

**Shoqëria permarimorë JUSTITIA**

Shoqëria permarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e dyte për shitjen e pasurisë së palleshme për le cilen ka vende hipotekë BKT BANK, në këto të dhëna:

Ø Pasuria "ARE" nr. 17/5, Zona Kadastrale 3339 me sipërfaqe 7780 m<sup>2</sup> faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Daurës, në pronësi të Z.Adrian Selzer Kapllani dt.08.03.1969, nj.Merita Myzafer Kapllani dt.24.06.1970 Në vlerën 8.120.000 (ete milion e njëqind e njëzetë mijë) Lekë.

Ø Pasuria Apartament me sip.120m<sup>2</sup> nr.pas.41/150+1-1 z.k.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh /13 Daurës në pronësi të Z.Adrian Selzer Kapllani dt.08.03.1969. Në vlerën 3.767.299 (tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 14.01.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor me adresë: Bulvardi Bajram Curri, Pall. 21, Shk. 3, Anp. 18, Tirane.

**KURBIN** - Pesë persona kanë përfunduar në pranga gjatë një operacioni të ndërmarrë dje nga policia e Qarkut të Lezhës dhe FNSH në kuadër të parandalimit të kultivimit të bimëve narkotike. Ndërsa janë shpallur në kërkim dy të tjerë. Sipas bluve, këtë persona në bashkëpunim me njëri-tjetrin po përgatisnin terrenin për të mbjellë lëndë narkotike në fshatin Godull të njësisë administrative Fushë-Kuqe të Kurbin. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "Godull 2019" janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale armë zjarri e municione luftar-

**Shkatërrohet "bahçja" me kanabis, në kërkim 2 të tjerë**

**Policia dhe FNSH, operacion antidrogë në Kurbin, përfundojnë në pranga 5 persona**

ake, kubikë të porsa mbjellë me kanabis dhe lëndë narkotike e llojit kokainë. "Në zbatim të detyrave të përcaktuara në Planin e Veprimit, për marrjen e masave për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, duke ushtruar kontroll periodik të territorit, si dhe bazuar në informacionet e marra në rrugë operative për disa shtetas që përgatiteshin për të kultivuar bimë narkotike në

zonën e quajtur Godull, është organizuar dhe zhvilluar operacioni i koduar 'Godull 2019', thuhet ndër të tjera në njoftimin e policisë. Ndërkaq, mësohet se si rezultat i operacionit u arrestuan në flagrancë shtetasit: B.Sh., 39 vjeç, banues në Mamurras; K.K., 59 vjeç, banues në Fushë-Krujë; K.Sh., 34 vjeç, banues në Mamurras; Gj.N., 34 vjeç, banues në Lezhë dhe V.Z., 41 vjeçe, ban-

uese në Kurbin. Gjithashtu, u shpallën në kërkim dy persona dhe po punohet intensivisht për kapjen e tyre. Po të njëjtat burime pohuan se gjatë operacionit u evidencuan kubikë të porsa mbjellë me fara kanabisi, si dhe sende të tjera që do të shërbenin për kultivim të bimëve narkotike. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan: 8000 kubikë ku ishin mbjellë fara kanabisi



Kubikët me kanabis

sativa, 5 doza të dyshuara lëndë e fortë narkotike kokainë, 2 armë zjarri "pistoleta", 1 armë zjarri automatik, 1 armë gjahu "shotgun", 680 fishekë dhe dy lbi e thikë. Materialet procedurale në ngarkim të shtetasve të proceduar u referuan

Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Kurbin për veprat penale "Kultivim i bimëve narkotike, kryer në bashkëpunim", "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike", "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarakë dhe municionit".

**Agresorët i bënë për spital se kishin konflikt me nipin e kryefamiljarit**

Eneida Petova

BERAT


Dy bashkëshortët Festim dhe Elida Selika janë dhunuar me sende të forta në banesën e tyre nga 3 persona, të cilët kishin shkuar për një sqarim. Ngjarja ka ndodhur në fshatin Gjoroven të Njësisë Administrative Velabisht në rrethin e Beratit, në sy të dy fëmijëve të mitur 3 dhe 4 vjeç. Mësohet se pak përpara se tre personat të shkonin në banesën e familjes Selika, e kanë parë kryefamiljarin Festim Selika duke pirë kafë në lokalin e fshatit me nipin e tij, me të cilin ata kanë pasur një konflikt të mëparshëm. Duket se kjo kafë ka qenë edhe sebebi i sherrit që ka ndodhur në banesën e çiftit Selika ku 3 personat, njëri prej të cilëve bashkëshortari i tyre, i kanë kërkuar llogari Festimit se pse po pinte kafë me personin që ata ishin në konflikt. Në debat e sipër, ata kanë qëlluar disa herë në kokë Festimin, i cili ka rënë pa ndjenja. Pasi ka ndërhyrë gruaja e tij, Elida, ata e kanë goditur edhe atë me gur në kokë dhe pasi e kanë përplasar disa herë në mur, e kanë goditur me shkelma e grushte në trup. E ndërsa, tre agresorët janë larguar, 35-vjeçarja ka njoftuar policinë. Çifti është dërguar me hematoma të shumta në Spitalin Rajonal të Beratit. Burime nga ky spital bënë me dije se gruaja ka marrë tri çarje të thella në kokë dhe plagë të shumta në trup, ndërkohë që bashkëshorti i saj është në gjendje më të mirë shëndetësore. Duke treguar të gjithë ngjarjen që terrorizoi edhe dy fëmijët e tyre, çifti Selika kërkoi nga shteti që përgjegjësit e këtij agresioni të vihen përballë drejtësisë, pasi ata pohuan se autorët e dhunës së ushtruar ndaj tyre nuk janë arrestuar dhe kjo i bën të ndihen më të kërcënuar për jetë. Mjeku kirurg në Spitalin Rajonal të Beratit, Piro Leka ka konfirmuar se çifti ka shenja dhune në trup, por



35-vjeçarja e plagosur, Elida Selika



Bashkëshortët Selika



**Sekuestrohen 3 mina me telekomandë, në pranga 2 të rinj nga Vlora dhe 1 në kërkim**

**LEZHË** - Dy persona kanë rënë në prangat e policisë në Lezhë si dhe janë sekuestruar 3 mina me shpërthim të komanduar nëpërmjet celularit. Sipas burimeve policore, gjatë operacionit të koduar "The long way", U arrestuan shtetasit: A.L. 23-vjeç nga Vlora, shtetasja me initiale A.E. 21

vjeçe nga Vlora. Ndërsa është shpallur në kërkim shtetasi E.E. 27 vjeç nga Vlora, i dënauar më parë. "Në vijim të punës për parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe goditjen e veprimtarive të kundërligjshme, duke vendosur përpara përgjegjësitë ligjore autorët e dyshuar, nga sektori për Hetimin e Kri-

meve në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, falë një pune profesionale të mirorganizuar, të ndjekur me metoda proaktive, u finalizua me sukses operacioni i koduar "The long Way", duke goditur një tjetër rast të tentativës për trafikim të mi-

nave me telekomandë", thuhet ndër të tjera në njoftimin e policisë. Përveç minave me telekomandë, blutë kanë sekuestruar edhe 2.3 kg lëndë narkotike dhe 1 telefon celular. Materialet procedurale në ngarkim të tyre u referuan në prokurorinë e Lezhës për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Trafikimi i lëndëve plasëse" dhe "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike".

**Çifti i bashkëshortëve rrihet në sy të fëmijëve, 1 në pranga e 2 nën hetim**

**Do vriste kreun e ALUIZNI-t me çifte, arrestohet 40-vjeçari**

**KUKËS** - Policia e Kukësit ka arrestuar një 40-vjeçar, pasi ka tentuar të vrasë me çifte kreun e ALUIZNI-t, Vladimir Spahiun. Bëhet fjalë për Petrit Hallaçin, i cili është përfshirë në sherr me Spahiun në institucion për shkak të detyrës. Pas konfliktit Hallaçi ka shkuar në shtëpi dhe ka referuar në web-in zyrtar ngjarjen në fjalë thjesht si një rast i "Plagosjes së lehtë me dashje e kryer në bashkëpunim" në qarkun Berat, me 1 person të arrestuar dhe 2 të proceduar në gjendje të lirë. Pak orë pas ngjarjes Policia e Beratit identifikoi autorët dhe arrestoi 20-vjeçarin Kristjan Berberi, banues në fshatin Pashalli, Ura Vajgurore si dhe procedoi në gjendje të lirë dy persona të tjerë. Bëhet fjalë për shtetasit: R.B., 47 vjeç dhe Sh.Sh., 39 vjeç, të dy banues në fshatin Gjoroven, Berat. Materialet në ngarkim të këtyre personave i janë përcjellë prokurorisë së Beratit për hetime të mëtejshme.





**TIRANË** - Krimet e Rënda kanë shtyrë për herë të tretë seancën gjyqësore për Klement Balilin, ku pritej të lexohej pretenca. Burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se pretenca është shtyrë për shkak të mungesës së avokatit të tij, Theodhori Sollaku, i cili nuk ka justifikuar mospresencën në sallë. Në kushte të tilla, gjykata ka vendosur një gjobë prej 10 mijë lekësh të reja për



Klement Balili

## Shtyhet për herë të 3-të seanca për Balilin, gjobitet avokati i tij, Theodhori Sollaku

avokatin, ndërsa seanca është shtyrë për në datën 8 prill, ditë kur prokuroria pritet të lexojë konkluzionet e saj. Në këtë seancë mungonte edhe vetë i pandehuri Balili, i cili me anë të një shkresë sqaroi se për arsye shëndetësore e kishte të pamundur të para-

qitej. Ai kërkonte që të përfaqësohej nga avokati Theodhori Sollaku, i cili të hënën është parë në ambientet e Gjykatës për Krimet e Rënda. Gjithashtu, këtë të martë mungonte edhe avokati i caktuar kryesisht nga gjykata një javë më parë, Remzi

Ponari. Ai kishte sjellë një raport, ku sqaronte se mungonte për arsye shëndetësore. Që prej datës 25 shkurt, në këtë proces gjykata nuk ka mundur të zhvillojë një seancë normale. Në të gjitha herët, shkak për shtyrjen është bërë mungesa e avokatit

Theodhori Sollaku. Klement Balili, i cilësuar si "Eskobari i Ballkanit" u vetëdorëzua pas negociatave me policinë më 15 janar të këtij viti. Më pas ai kërkoi gjykim të shkurtuar, gjë e cila iu pranua nga gjykata. Prokuroria e akuzon Balilin për trafik droge, grup të strukturuar kriminal, pastrim parash dhe fshetje pasurie. Sipas hetimeve, është provuar që 47-vjeçari ka marrë pjesë në trafikun e dy ngarkesave me kanabis.

Talal Ahmed Abu Mayha dhe 2 shqiptarët hiqeshin si investitorë në Shqipëri

# U premtinin egjiptianëve pasaporta shqiptare deri në 20 mijë euro, arrestohet arabi

*Procedohet në gjendje të lirë një 41-vjeçar dhe shpallet në kërkim një grua 49-vjeçare*

20

### MIJË EURO

Sipas burimeve zyrtare nga policia e Tiranës, këta persona në bashkëpunim me njëri-tjetrin duke u kamufluar si investitorë dhe partnerë për investime në Shqipëri, u premtinin shtetasve të huaj me kombësi egjiptiane që shfaqnin interes se mund t'iu siguronin atyre pasaporta të shtetit shqiptar për shumën e 20 000 euro.



nëpërmjet një zyre binjakëzimi midis Emirateve të Bashkuara dhe Tiranës, u kanë marrë disa shtetasve shumën të konsiderueshme në

euro, duke iu premtuar leje qëndrimi dhe pasaporta shqiptare (por që nuk kanë bërë të mundur dot as aplikimin për dokument të tillë si pasaporta dhe leja e qëndrimit për shkak të rregullave dhe dokumenteve strikte që kërkoheshin nga zyra e kufirit dhe migracionit).

### HETIMET

Nga hetimet e kryera ka rezultuar dhe është provuar se shtetasit e lartpërmendur nëpërmjet një zyre binjakëzimi midis Emirateve të Bashkuara dhe Tiranës, u kanë marrë disa shtetasve shumën të konsiderueshme në euro duke iu premtuar leje qëndrimi dhe pasaporta shqiptare (por që nuk kanë bërë të mundur dot as aplikimin për dokument të tillë si pasaporta dhe leja e qëndrimit për shkak të rregullave dhe dokumenteve strikte që kërkoheshin nga zyra e kufirit dhe migracionit).

por dhe leja e qëndrimit për shkak të rregullave dhe dokumenteve strikte që kërkoheshin nga zyra e kufirit dhe migracionit). Ndërkaq, në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar: zyra në Tiranë e shtetasit të arrestuar arab, tri njësi kompjuterash të ndryshëm, një aparat celu-

lar, dokumente të ndryshme. Materialet procedurale u kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur, për veprat penale "Mashttrim", "Fshetje e të ardhurave" dhe "Mospagim i taksave dhe tati-



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 8,660,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 24 Prill 2019, ora 14:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## Kreu i Apelit të Krimeve të Rënda para vetingut, KPK: Fehmi Petku fshehu pasurinë

**TIRANË** - Duket se pasuria e pajustificuar është një nga problemet e evidentuara për kreun e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, Fehmi Petku, që ka radhën e vetingut. Ai ka dalë dje para KPK, ku u zhvillua seanca dëgjimore me trup gjyqësor të përbërë nga: Genta Tafa Bungo, Xhensila Pine dhe Pamela Qirko. Petku është paraqitur pa avokat mbrojtës në seancë. Sipas relatimit të KPK të raportit të ILDKPI, deklarimi i pasurisë nuk është i saktë, ka fshetje pasurie, deklarim të rremë dhe nuk ka konflikt interesi. Nga hetimi i thelluar i KPK ka rezultuar se ai ka pasuri në



Fehmi Petku

pjesë takuese: Truall 272 m blerë nga babai i tij, 1/4 e një banesë të ndërtuar në këtë truall, 1/4 e një sipërfaqeje 700 m<sup>2</sup>; 1/4 e një sipërfaqeje 2000 m<sup>2</sup>, 1/4 truall 16 mijë m<sup>2</sup>

blerë nga babai në 1996. Duke qenë se këto pasuri janë trashëguar nga babai, hetimi u thellua tek hetimi i pasurisë së babait. KPK tha se Petku në vitin 1999 ka gjykuar një dosje për Vehbi Alimuçën, ish-kreun e firmës piramidale VEFA, kohë kur babai i tij kishte marrëdhënie interesi. KPK deklaroi se duket se ka mungesë të burimeve të ligjshme të pasurisë së babait të tij dhe ka konflikt në gjykimin e Vehbi Alimuçës kur babai kishte marrëdhënie interesi. Po kështu sipas KPK, ka mungesë dokumentacioni për justifikimin e një trualli prej 16 mijë m<sup>2</sup>.

## KARTA E STUDENTIT PROJEKTVENDIMI

Voltiza Duro

Studentët do të përfitojnë një sërë shërbimesh me çmime të reduktuara, pas pajisjes me kartën e studentit. Në projektvendimin e Këshillit të Ministrave parashikohet miratimi i listës së shërbimeve të ofruara nga ky dokument unik që do të disponojë çdo i ri që ndjek studimet e larta. "Shërbimet që ofrohen nga entet shtetërore në fushën e artit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimi dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes, përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, si një dokument unik i çdo studenti", thuhet në projektvendim. Ndërkohë, efektet financiare nga reduktimi i çmimeve do të përballohen nga buxheti i ministrave, sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore. Mbjajtësit e kartës së studentit do të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara edhe nga subjektet tjera publike apo private, që kanë për objekt të tyre interesa studentore, në bazë të marrëveshjeve përkatëse pa efekte financiare për buxhetin e shtetit, të nënshkruara me Ministrinë përgjegjëse për Arsimin.

**PËRFITIMET JASHTË VENDIT**  
Mbjajtësit e kartës së studentit, do të përfitojnë të gjitha shërbimet e ofruara sipas përcaktimeve të këtij vendimi, nëpërmjet paraqitjes së kartës së studentit si dokument unik. Shërbimet e ofruara sipas përcaktimeve të këtij vendimi do të bëhen publike nga të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, si dhe nga subjektet publike dhe private në faqet e tyre zyrtare, ndërsa ministria përgjegjëse për arsimin do të publikojë të gjitha shërbimet e siguruar me çmime të reduktuara për mbajtësit e kartës së studentit. "Karta e studentit mund të bëhet pjesë e projekteve ndërkombëtare, përmes marrëveshjeve që lidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin, miratimin miratimit, brenda 10 ditëve pune nga njoftimi i marrëveshjes. Në rast se konfirmimi nuk paraqitet brenda 10 ditëve pune, miratimi konsiderohet i dhënë", bëhet me dije në projektvendim. Në këtë të fundit thuhet se ministria përgjegjëse për arsimin miraton me udhë-

Këshilli i Ministrave: Si do të bëhet konfirmimi i studentëve përfitues

# Karta e studentit, projektvendimi: Çfarë do të përfitojnë studentët

*Lista e plotë e shërbimeve me çmim të reduktuar*



### PËRFITIMET NDËRKOMBËTARE

Karta e studentit mund të bëhet pjesë e projekteve ndërkombëtare, përmes marrëveshjeve që lidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kjo pjesëmarrje mundëson që shërbimet e ofruara nga këto projekte të përfitohen nga të gjithë mbajtësit e kartës së studentit në shtetet anëtare të projektit apo marrëveshjeve ndërkombëtare.

dentit në shtetet anëtare të projektit apo marrëveshjeve ndërkombëtare. Efektet financiare të pjesëmarrjes në projektet ndërkombëtare, përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin. "theksohet në projektvendimin e Këshillit të Ministrave.

**MARRËVESHJET**  
Në nivel vendor, marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për mbajtësit e kartës së studentit do të nënshkruhen ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve do të përballohen nga buxheti e njësive të vetëqeverisjes vendore.

"Njësitë e vetëqeverisjes vendore nënshkruajnë marrëveshje me subjekte tjera publike dhe private për ofrimin e shërbimeve me çmime të

reduktuara për mbajtësit e kartës së studentit. Çdo institucion i arsimit të lartë mund të nënshkruaj marrëveshje pa efekte financiare me subjekte publike apo private për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në nivel qendror apo vendor, me çmime të reduktuara për mbajtësit e kartës së studentit. Marrëveshjet e lidhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e arsimit të lartë, marrin miratimin paraprak në Ministrinë përgjegjëse për Arsimin. Ministria përgjegjëse për Arsimin konfirmon miratimin, brenda 10 ditëve pune nga njoftimi i marrëveshjes. Në rast se konfirmimi nuk paraqitet brenda 10 ditëve pune, miratimi konsiderohet i dhënë", bëhet me dije në projektvendim. Në këtë të fundit thuhet se ministria përgjegjëse për arsimin miraton me udhë-

zim formën, procedurat e përgatitjes dhe administrimit të kartës së studentit. Në rast se prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit, i delegohet njësive të vetëqeverisjes vendore, atëherë ministria përgjegjëse për arsimin, nënshkruan një marrëveshje dypalësh me këto njësi mbi delegimin e këtyre përgjegjësisë dhe kompetencave. Shpenzimet për prodhimin dhe administrimin e kartës së studentit do të përballohen nga buxheti i Ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Në rast se prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit do të delegohet te njësitë e vetëqeverisjes vendore, atëherë, shpenzimet do të përballohen nga buxheti i këtyre njësive.

### KONFIRMIMI I STUDENTËVE

Ndërkohë, çdo vit akademik Qendra e Shërbimeve Arsimore, do të bëjë konfirmimin për studentët e regjistruar në vitin përkatës akademik për çdo institucion të arsimit të lartë, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në rastin e delegimit të prodhimit dhe administrimit të kartës së studentit.

### PUBLIKIMI I SHËRBIMEVE

Mbjajtësit e kartës së studentit do të përfitojnë të gjitha shërbimet e ofruara sipas përcaktimeve të këtij vendimi, nëpërmjet paraqitjes së kartës së studentit si dokument unik. Shërbimet e ofruara do të bëhen publike nga të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, si dhe nga subjektet publike dhe private.

### VERIFIKIMET

Çdo vit akademik Qendra e Shërbimeve Arsimore do të bëjë konfirmimin për studentët e regjistruar në vitin përkatës akademik për çdo institucion të arsimit të lartë, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në rastin e delegimit të prodhimit dhe administrimit të kartës së studentit.

### LISTA E KATEGORIVE TË SHËRBIMEVE QË OFROJNË ENTET SHTETËRORE

#### Shërbime në fushën e kulturës

► hyrje në biblioteka, muze, galeri arti, parqe arkeologjike dhe monumente të kulturës,

► hyrje në teatër dhe shfaqje artistike

#### Shërbime në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale

► Shërbime shëndetësore pjesë e listës së barnave të rimbursueshme, të paketa të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe të kujdesit spitalor që mbulojnë nga skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor;

► Përfshirje dhe reduktim nga pagesat e drejtpërdrejta, për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme,

► Sigurim shëndetësor,

► Regjistrim në çerdhe dhe kopshte për fëmijët e studentëve apo strehim social.

Shërbime në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë

► studentët do të përfitojnë hyrje në stadione, pallate sporti, palestra dhe aktivitete sportive.

Shërbime në fushën e transportit

► transporti publik i të gjitha llojeve, përfshirë dhe transportin ajror,

► kurse dhe lëshim patentash dhe dokumentesh të tjera të ngjashme.

\*Studentët do të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara edhe nga subjektet tjera që kanë objekt të tyre interesa studentore, si dhe nga persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme, në bazë të marrëveshjeve përkatëse të lidhura konform përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

"Ngarkohen ministrinë sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore, Qendra e Shërbimeve Arsimore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, entet shtetërore,

si dhe institucionet e arsimit të lartë, për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare", thuhet në projektvendim.

Presidenti Ilir Meta përruron ekspozitën e piktorit autik, mesazhet e sensibilizimit

Voltiza Duro

# Dita Botërore e Autizmit, pagesa të diferencuara për fëmijët e prekur

## Manastirliu: Do të zgjerohen shërbimet në territor

Fëmijët me çrregullime të spektrit autik do të kenë pagesa të diferencuara të pagesës së Kemp-it, në bazë të shkallës së dëmtimit mjekësor si dhe do të zgjerohen shërbimet sociale në territor. Në Ditën Botërore të Autizmit, ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, vizitoi Qendrën e Zhvillimit "Pëllumbat", ku trajtohen fëmijë me aftësi të kufizuara, mes tyre edhe fëmijë me çrregullime të spektrit autik. "Reforma që kemi ndërmarrë për vlerësimin bio-psiko-social të personave me aftësi të kufizuara, ku përfshihen edhe fëmijët me çrregullime të spektrit autik, e cila ka nisur të pilotohet në Tiranë, do të na japë mundësi për të mbështetur më shumë në pagesa ato kategori të cilat janë në gjendje më të rëndë, duke bërë një diferencim me ato kategori që janë me problematika më të lehta dhe që mund të trajtohen përveç ndihmës në cash edhe me shërbime sociale", - u shpreh Manastirliu.

### SHËRBIET

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u shpreh se do të shtohen shërbimet në territor me Fondin Social, që vihet në dispozicion të çdo Bashkie. "Për të gjitha ato bashki ku këto shërbime mungojnë, apo janë të pamjaftueshme, me Fondin Social të miratuar së fundmi, do të mbështeten bashkitë të ngrënë shërbime të reja apo të zgjerohet gamën e shërbimeve që ofrojnë, përfshirë këtu edhe ofrimin e shërbimeve rehabilituese dhe integruese për fëmijë me çrregullime të spektrit autik dhe aftësi të kufizuara", tha Manastirliu. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tha se lehtësimi i procedurave për përfitim të pagesës së aftësisë së kufizuar, ka ndikuar drejtpërdrejt në eliminimin e burokracive. "Lehtësuam procedurat për pagesat e KMCAP për fëmijët me autizëm dhe



**ILIR META: DASHURI E PËRKUJDESJE**  
"Me rastin e Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin, mesazhi ynë i përbashkët është për më shumë përkujdesje, dashuri dhe socializim për të gjithë fëmijët me autizëm, të cilët e meritojnë të gjithë përkrahjen tonë për të zhvilluar aftësitë e tyre. Shoqëria ka ende shumë nevojë për të rinj që shfaqin solidaritet", - tha Meta



**OGERTA MANASTIRLIU: TRAJTIMI I DIFERENCUAR**  
"Reforma që kemi ndërmarrë do të na japë mundësi për të mbështetur më shumë në pagesa ato kategori të cilat janë në gjendje më të rëndë, duke bërë një diferencim me ato kategori që janë me problematika më të lehta dhe që mund të trajtohen përveç ndihmës në "cash" edhe me shërbime sociale", - u shpreh Manastirliu.



kujdestarët e tyre. Sot personi me aftësi të kufizuara nuk paraqitet më në komision, pasi vlerësohet vetëm dokumentacioni që përmban dosja e tij. Për personat me autizëm nuk

ka më rikomisionim të përvitshëm dhe kjo është një lehtësi e madhe për qindra prindër që çdo vit bashkë me fëmijët e tyre, që edhe ata duhet të paraqiteshin në komisione, kalo-

nin një kalvar të vërtetë mundimesh", - tha Manastirliu. Reforma e nisur për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, ku përfshihen edhe fëmijët autikë, vlerëson jo vetëm

nevojat mjekësore por edhe kontekstin social të individit. Do të ketë përshkallëzim të masës së përfitim, në varësi të nivelit të dëmtimit mjekësor, si dhe diferencim në masën e përfitim për fëmijët dhe të rriturit. Kjo reformë orientohet drejt shërbimeve konkrete dhe jo thjesht drejt përfitim të pagesës në cash (KMCAP). Nga të dhënat në rang kombëtar, gjatë viteve të fundit vihet re një rritje e numrit të fëmijëve që trajtohen pranë qendrave komunitare të shëndetit mendor (rreth 942 fëmijë trajtohen në këto qendra në Tiranë). Pjesa më e madhe vijnë me rekomandim të konsultorit të lagjes, një tregues ky që flet për rritjen e ndërgjegjësimit për çrregullimet e spektrit autik.

### EKSPOZITA NË PRESIDENCË

Në Ditën Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit për Autizmin, Presidenti i Repub-

likës Ilir Meta, prezantoi piktorin 21-vjeçar Drini Sallaku. Meta tha se në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit për Autizmin, nën kujdestarinë e tij personal u përrua në mjediset e Institucionit ekspozita me 20 piktura të autorit 21-vjeçar, studentit me aftësi ndryshe, Drini Sallaku. "Shumë i lumtur të nisja ditën duke i uruar mirëseardhjen në Presidencë, Drini Sallakut, një student me aftësi ndryshe, por jashtëzakonisht i talentuar në pikturë. Së bashku me shokët e shoqet e tij, si dhe me mësues të Liceut Artistik "Jordan Misja", ne patëm kënaqësinë të përruonim edhe ekspozitën e 11-të të Drinit me 20 piktura, i cili tashmë ndihet i mirintegruar në klasën dhe shkollën e tij", tha presidenti. Ky i fundit bëri thirrje për më shumë përkujdesje, dashuri dhe socializim për të gjithë fëmijët me autizëm. "Sot me rastin e Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin, mesazhi ynë i përbashkët është për më shumë përkujdesje, dashuri dhe socializim për të gjithë fëmijët me autizëm, të cilët e meritojnë të gjithë përkrahjen tonë për të zhvilluar aftësitë e tyre.

Shoqëria shqiptare ka ende shumë nevojë për të rinj që shfaqin solidaritet dhe të cilët janë faktor i rëndësishëm për të sjellë ndryshimin e madh në kauzat sociale. Falënderim të veçantë për nënën e Drinit, Edlirën dhe për të gjitha nënat e mrekullueshme që kujdesen me shumë dashuri për rritjen dhe edukimin e fëmijëve me aftësi ndryshe", tha Meta.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shtypja e botimeve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,068,400 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shtypja e botimeve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 25 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje një pajisje UPS për nevojat e një "Server Room" të Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,700,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje një pajisje UPS për nevojat e një "Server Room" të Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 24 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Gjyqi në Apel, prokurori: Të lehtësohet masa e sigurisë për 3 nga 12 të akuzuarit

SHKODËR

Prokuroria në Shkodër gradualisht ka nisur që të tërhiqet nga akuzat e rëndë për personat e arrestuar, në kuadër të operacionit të koduar "Maranaj", të cilët dyshohen për dhënie fajdesha ndaj djemve dhe vetë ish-prefektit të Shkodrës, Paulin Radovani. Në fund të seancës që u zhvillua për 4 orë me radhë në Gjykatën e Apelit në Shkodër, prokurori i çështjes, Ibrahim Dragjoshi pranoi para gjykatës që të paktën për tre të dyshuar të lehtësohet masa e sigurisë "arrest me burg" dhe pikërisht për shtetasit Naim Ahmeti, Adri Bala dhe Lulzim Sylja. Për 9 të tjerët i qëndroi kërkesës për "arrest me burg". Gjykata e Apelit e shtyu për ditën e sotme vendimin e saj për 12 të arrestuarit. Thuajse të gjithë të dyshuarit kanë dhënë dëshmitë e tyre në një seancë, që u zhvillua me detyrë të hapura. Bërhan Alija u përfaqësua nga avokati i tij. Avokati mbrojtës mohoi se klienti i tij i ka dhënë para me fajde ish-prefektit apo dy djemve të tij. E vetmja gjë është blerja e një makine. Avokati mbrojtës tha se në mënyrë të padrejtë dhe të jashtëligjshme i janë sekuestruar klientit të tij të gjitha makinat që ndodheshin tek servisi, që posedon në hyrje të qytetit. Me pas radha ishte për ish-kancelarin e gjykatës, Artan Dragani. Avokati mbrojtës u shpreh se klienti i tij, duke pasur lidhje miqësore me djemtë e ish-prefektit u ka dhënë një shumë parash borxh për t'i ndihmuar në situatën e vështirë ekonomike, por jo me shtesë ose siç quhen me fajde. I arrestuari tjetër, Edi Memçaj dha dëshminë e tij duke thënë se nuk është e vërtetë se u ka dhënë para me fajde djemve të ish-prefektit. Memçaj u shpreh se u ka blerë një tokë djemve të tij në Velipojë në shumën 10 milionë lekë dhe një dyqan motrës të ish-prefektit Radovani. "Jam munduar të shtoj bizneset, sepse më ka lënë pastruri babal dhe i kam trashëguar dhe jo si Paulin Radovani që i çon djemtë të droga, kumari apo i përdorë paratë për blerje votash. Sa borxhe ka ish-prefekti nuk e nxë as burgu i Shën Kollit dhe s'do ketë burg që e nxë. Unë nuk e di me kë jam në grup se nga të ndaluarit veç më dy tre kam njohje dhe asgjë më shumë. Paratë i kam kaluar me banka dhe jo si Paulini që i ka fshehur. E dini ju se ka futur një djalë jetim të marrë në emrin e tij 250 mijë euro kredi në bankë. Janë fotot e djemve të ish-prefektit duke u marrë drogë, duke luajtur kumar, çfarë faji kam unë se i kam blerë pronat". Në të njëjtën linjë ishte edhe avokati mbrojtës i Marjan Bregut, i cili e quajti atë që ka bërë ish-prefekti si një skemë piramidale. "Marjan Bregu, mësuens në shkollën e mesme 'Jordan Misja', peshëngëritës i Villaznisë i ka pasur shokë djemtë e ish-prefektit", tha avokati mbrojtës dhe sot është i arrestuar dhe ata që kanë mashtuar janë të lirë. Duke pasur lidhje shoqërore e ka ndihmuar duke u dhënë para borxh, por asnjëherë me fajde. Përgjimet ambientale të pretenduar janë të jashtëligjshme, sepse ish-prefekti herë e ka mbajtur nëzbur regjistruar herë e ka fikur sipas dëshirës.

Lulzim Sylja, një tjetër i ndaluar u përfaqësua nga avokati mbrojtës. Ky i fundit tregoi se shtetasi Lulzim Sylja i ka dhënë një borxh prej 120 mijë euro. Është e pavërtetë që Lulzim Sylja ka kërcënuar ish-prefektin siç pretendohet. Pasi Lulzim Sylja i ka kërkuar lekët e borxhit, ish-prefekti i ka ofruar një tokë të një ish-fabrikë në Pukë për t'ia shitur duke marrë parasysh edhe shlyerjen e borxhit. Lulzim Sylja ka thirrur një mik të tijin, shtetasin Naim Ahmeti duke i treguar për këtë rast dhe ky i fundit ka rënë dakord për ta blerë atë tokë. Pasi është bërë kontrata në Drejtorinë e Tatimeve ka rezultuar një shumë prej 45 milionë lekësh të vjetër tatim-taksa që duhej paguar. Ish-prefekti s'ka pranuar ta paguajë atë shumë që i detyrohej shtetit dhe kështu marrëveshja mes tyre është prishur për shitjen e tokës, duke i bërë sërish borxh prej 120 mijë euro. Edhe avokati e Naim Ahmetit u shprehën të shokuar se si ka mundësi që për një person si klienti i tyre që thirret nga një mik për të blerë një tokë merret masë sigurimi në mungesë "arrest me burg". Ilir Sokoli, ish-drejtori i patentave në Shkodër dha dëshminë e tij para Gjykatës së Apelit, duke treguar ai dhe avokati se si ky shtetas ka qenë mik shumë i ngushtë me dy djemtë e ish-prefektit Radovani dhe miq edhe familjarisht. Avokati

# Të arrestuarit për fajde "masakrojnë" në gjyq ish-prefektin e Shkodrës, Paulin Radovani

## I pandehuri Edi Memçaj: I çoi djemtë të droga dhe kumari, i përdori paratë për blerje votash



Ish-prefekti i Shkodrës, Paulin Radovani

mbrojtës u shpreh se është qesharake që prokuroria ngre këto akuzë, me qëllim që të justifikojë masat e sigurisë, një histori që përsëritet prej 30 vitesh. Organi i akuzës s'ka bërë hetim fare tha avokati i Ilir Sokoli dhe tregoi se 25 mijë euro ia ka dhënë borxh për të paguar pagat e punëtorëve të fabrikës. Vetë ish-drejtori Sokoli dëshmoi se përveç faktit se i ka pasur miq Robert dhe Elton Radovani tregoi se e ka takuar ish-prefektin duke i thënë se çfarë do që të bëjë me ata që familja Radovani i ka borxhe. Ilir Sokoli tregoi se ka

mijë të tjera kanë qenë fajde në favor të Nikprelaj. Avokati tha se klienti i tij ka marrë kredi për të shlyer këtë shumë me të cilën ka blerë tokën. Vetë Nikprelaj dëshmoi se është takuar disa herë me ish-prefektin dhe se ky i fundit e ka marrë disa në telefon. "Më merrte disa herë në telefon duke më pyetur a doli kredia. Kushti në kontratë ka qenë që në momentin që do më aprovohej kredia, toka të ishte e imja. Kur u miratua kredia i kam kaluar paratë. Një ditë para arrestimit isha me të noteri tekasa bëmë procedurën e fundit. Me mua nuk ekzistoi asnjëherë fjala fajde, thjesht i kam blerë tokën, sepse kam bërë kontratë qiraja me kompanitë e sigurimeve duke qenë se përballë asaj toke pritej të vinte drejtorja e transporteve". Adri Bala është një tjetër i ndaluar që në një moment ka qenë thjeshtë shoqëruar dhe i del emri shkurtimisht në përgjime. Avokati mbrojtës i shtetasit Eduart Fusha pranoi se klienti i tij u ka dhënë një borxh djemve të ish-prefektit, por jo me fajde, thjesht për t'i ndihmuar për shkak të lidhjeve shoqërore që kanë pasur. Borxhin ia ka dhënë me idenë për të shlyer pagat e punonjësve të fabrikës dhe përgjimet janë të stimuluar pretendohet edhe në këtë rast. Edhe për shtetasin Elidon Qerimaj, avokati mbrojtës pranoi se i ka dhënë djemve të ish-prefektit Radovani, fillimisht 18 mijë euro Robertit dhe më pas 5 mijë euro Eltonit, por për t'i ndihmuar për shkak të lidhjeve shoqërore.

Dëshmia më e gjatë dhe shuma më e madhe është dhënë nga Pashko Vuksanelaj, nga ashtu i ndaluar. Fillimisht avokati mbrojtës tregoi se borxhin ia ka dhënë me 3 për qind në vit duke qenë se këtë hua e njeh ligji. Sipas avokati të Vuksanelaj, nga janari i këtij viti dhe deri në fillim të marsit ish-prefekti Radovani rezultoi se ka marrë vetëm në një muaj e gjysmë 1 milion e 400 mijë euro vetëm borxhe, këtyre të ndaluara, por edhe personave tjerë që s'janë fare pjesë e këtij procesi. Akuzoi se prokuroria e rrethit dhe disa

gjyqtarë të shkallës së parë kanë mbajtur linjën e ish-prefektit për shkak të lidhjeve të tyre. Më pas dha dëshminë e tij vetë i dyshuari Pashko Vuksanelaj. "Ai vendim në shkallë e parë është dhënë nën presion politik. Gabimet duhen pranuar. Dy ditë përpara ishte në Shkodër kryeprokurorja kurse një ditë para kryeministri përgëzoi policinë në një kohë kur ky kryeministër ka fyer të gjitha institucionet dhe i ka kërcënuar. Paulin Radovani në vitin 1997 kur pati probleme të fabrikës, pasi iu dogji shkoi në Malin e Zi tek disa njerëz të mi. Kur u kthye dhe rimisi punën në fabrikë, më thirri mua dhe njerëzit e mi dhe na dha një drekë, aty e njohta. Në korrik 2018 më merr në telefon, por unë isha në spital. Pasi dola më mori prapë. Shkova dhe e takova dhe më çoi të një tokë afër fabrikës. Më tha që i kishte premtuar Edi Rama se në tokën e tij do të sjellë drejtorinë e transporteve ose targat siç i themi, por më tha se i duheshin 50 mijë dollarë se ishte në vështirësi. I thashë se do e ndihmoj dhe kur ia dërgova kishte përgatitur një deklaratë jo në prezencën time dhe nga besimi që kisha ia dhashë paratë dhe e firmosa. Pas pak kohësh më mori prapë dhe më tha jam në dorën tënde se po falimentoj. Më duhen më tha edhe 50 mijë dollarë për të paguar tatim taksat e punëtorëve të fabrikës. Ia dhashë. Më mori herën e tretë dhe më tha se më duhen edhe 50 mijë të tjera, duke më treguar se deri në fund të 2018-ës, ai do të përfitonte 1 milion e gjysmë euro duke qenë se të toka e tij priste t'i shkonte Drejtoria e Transporteve. Ia dhashë sërish edhe herën e tretë dhe u bënë 150 mijë dollarë në total. Këto ia kam dhënë me 3 për qind në vit. Në fund të vitit duhej të mi kthente, por s'ma ktheu borxhin. Shkoj ta takoj dhe më thotë se kishte takuar në Tiranë zëvendës drejtorin e përgjithshëm të policisë, Gjovalin Loka, duke i treguar për kërcënimet dhe problemet. Mua më tha se ia kanë vrarë djemtë dhe se nuk e di ku i kishte, e inskenoi vrasjen e djemve, sepse ata ishin gjallë dhe thjesht kishin ikur nga Shqipëria. Në fillim të vitit kam dashur ta takoj disa herë, por nuk përgjigjej në telefon. Një ditë e takova poshtë pallatit të tij dhe më çoi në kafe. Më tha kështu e ka puna ime, lekët t'i kam borxh, por për momentin s'i kam, ndërsa më tregoi sërish bisedat e tij me Edi Ramën për 1 milion e gjysmë euro që priste ende të përfitonte. Pra, unë jam mashtuar nga Paulin Radovani". Të gjithë të dyshuarit dhe avokatët

mbrojtës të tyre kanë kërkuar që për ta gjykata të vendos masën lehtësuese të sigurisë "detyrim paraqitje" dhe të hetohen të lirë sepse s'janë persona të rrezikshëm. Në fund prokurori i Apelit kërkoi që për tre prej tyre të lehtësohet masa e sigurisë, ndërsa nuk pati përgjigje për argumentet dhe faktet që shtuan 12 të ndaluarit dhe avokatët e tyre. Edhe gjykata e pyeti prokurorin se si është e mundur të ketë një dosje të tillë copë, por nuk dha përgjigje ndërsa u mjaftua, duke thënë se të gjithë kanë pasur interes në borxhet e dhëna. Gjykata e Apelit shtyu vendimin me 3 prill në orën 14:50.

**PARATE E SEKUESTRUARA**

- 238 600 Euro CASH
- 272 400 dollarë CASH
- 414 000 Lekë
- 510 Paund Britanik
- 20 automejta transporti
- 1 revolver,
- 1 krehër pistolette me fishekë
- 1 armë gjahu pa leje
- 5 kompjutera laptop
- 50 celularë

qenë vetë ish-prefekti që i ka kërkuar të futet si ndërmjetës të shtetasit Vinko Nikprelaj, në mënyrë që ky i fundit të blinte një tokë që kishte familja Radovani tek fabrika e tyre. Ilir Sokoli tregoi se e ka ditur se është në përgjim, ndërsa edhe pas dy muajsh e ka mbajtur po të njëjtin numër celulari, sepse s'kam pasur arsye ta ndërroj sepse ishim miq. Nga ana tjetër, për shtetasin Vinko Nikprelaj avokati mbrojtës tregoi historinë se si përgjimet ambientale të ish-prefektit janë të paligjshme dhe u shpreh se në fabrikën e tij ku janë regjistruar të ndaluarit kanë shkruar edhe deputet për ta takuar, edhe Presidenti aktual i Republikës dhe shumë personazhe të tjerë. Avokati i Nikprelaj tha se klienti i tij i ka blerë një tokë prej 140 mijë euro dhe paratë ia ka kaluar me bankë dy ditë para se të ndalohej. Është i pavërtetë pretendimi i ish-prefektit se në akt-shitje është shkruar 140 mijë euro dhe jo 240 mijë euro, sepse 100

**AKUZAT NDAJ TE DYSHUARVE**

Prokuroria: Pas një hetimi proaktiv disamujor, u siguruan prova për 19 të dyshuar, për veprat penale të "Pastrimit të Produkteve të Veprës penale", "Ushttrim aktiviteti financiar të palicënsuar", "Shpërdorim detyre", "Prodhim dhe Mbajtje pa leje e armeve luftarakë dhe municioneve" dhe "Mos kallzim krimi".

# VIP

Suplement  
Pages

Enë mërkurë 3 Prill 2019

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj

## "BULEVARDI POLITIK"

- Dreka, "gratë" e Fatos Nanos mbliidhen bashkë
- Xhelozia mes socialistëve, Kodheli: Punova 4 vjet për bazën ajrore të Kuçovës
- Erjon Braçe kishte ditëlindjen, ja deputetja që e uroi e para
- Merkel i dhuron Manastirit të Assisit pjesë nga Muri i Berlinit



Ledina Çelo poston videon provokuese e sapodalë nga dushi



"Bëja qejfin sheikut se të paguan mirë", Elhaida Dani reagon ashpër ndaj komentuesit



Flet kampioni i peshëngritjes: Jam përballur me superfuqi botërore e kam fituar



I treti në Botëror, **Erkand Qerimaj**: Së shpejti, në Gjeorgji për garat paraolimpike

"Njeriu e tregon veten në momentet e vështira"

Flet kampioni i peshëngritjes: Jam përballur me superfuqi botërore e kam fituar

# I treti në Botërorin e SHBA, Erkand Qerimaj: Së shpejti, në Gjeorgji për garat para olimpikut

"Njeriu e tregon veten në momentet e vështira"

Pamela Aliaj

**K**ampioni shqiptar i peshëngritjes, na ka bërë krenarë sërish së fundmi me fitoren e vendit të tretë me medalje bronzit në Kampionatin Botëror të zhvilluar në Anaheim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës një vit më parë. "Zyrtarizohet marrja nga ana ime e Medaljes së Bronzit e Kampionatit Botëror që u zhvillua në Anaheim. Sukses i madh i imi personal, trajnerit tim Zef Kovaçi edhe i sportit shqiptar! Tashmë medaljeve të mia i shtohet edhe ajo e vendit të tretë në botë", ka shkruar Erkand Qerimaj në rrjetet sociale. Ndërkaq ai është duke u përgatitur për një tjetër sfidë, atë të këtij viti në Europë. Në një intervistë ekskluzive për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", kampioni ynë na rrëfen prapaskenat e përgatitjeve, emocionet para konkursit si dhe detaje të tjera nga jeta e tij jashtë sportit të peshëngritjes. Për më tepër në intervistën e mëposhtme:

## Si ndiheni pas fitores së medaljes së bronzit në SHBA?

Ndihem shumë i lumtur, sepse është vendi i tretë në botë. Jam përballur me superfuqi botërore Gjermania, Kina etj. dhe është një emocion i papërshkueshëm. Kam qenë shumë i emocionuar. Për të rritur kjo ka qenë medalja më e rëndësishme.

## Me çfarë po përgatiteni tani për botërorin? A keni pasur suportin e duhur nga ministria?

Në datën 7 prill nisemi, kemi kampionatin Europian që zhvillohet në Gjeorgji. Është gara e radhës kualifikuese për lojërat olimpike. Jo nuk kemi patur suportin e duhur. Duhet të ketë më tepër vëmendje se është një konkurs për një medalje botërore. Për sportin shqiptar, kjo ishte arritja më e madhe kështu që duhet të kishte më tepër suport.

## Si ka ndryshuar jeta juaj pas arritjes në jetë të djalit, Dijarit?

Ka patur normalisht ndryshime. Kur bëhesh prind duhet të përkushtohesh ndaj fëmijës. Por ne pavarësisht gjithë përgjithësisë, ne edhe gjejmë kohë të dalim e të kemi kohë për njëri-tjetrin. Ne ia plotësojmë gjithë gjërat e nevojshme fëmijës, por edhe prindërit na ndihmojnë.

## Nga çfarë keni hequr dorë si çift tani që jeni bërë prindër?

Nuk dalim aq shpesh sa më parë apo të udhëtojmë. Normalisht që tani dalim edhe me djalin, të tre, por, siç thashë më parë, e gjejmë kohën që të kemi edhe momentin për të qenë bashkë. Mendojemi që të mos humbim ato gjëra që i kemi pasur më përpara si çift.



Ju ndiqni një dietë të fortë për stërvitje. **Çfarë keni hequr nga ushqimi juaj që e keni të preferuar për shkak të stërvitjes?**

Zakonisht unë i konsumoj të gjitha ushqimet. Por tani që po bëj nga pasha, gati 2-3 kg nuk më duhet të konsumoj brumrat dhe ëmbëlsirat. Gjithmonë jam në dietë, por përpara garave kemi një dietë

më strikte. **Çfarë roli luan gruaja juaj tek ju? A është prezente në stërvitjet tuaja apo vetëm nëpër konkurse?**

Zakonisht është gjithmonë prezente. Ajo është një mbështetje shumë e madhe për mua. Asaj i duhet të kujdeset për fëmijën përveçse për mua. Bashkëshortja

është gjithmonë aty kur kam nevojë për ushqimin, regjimin etj. Nuk ka qenë prezente në konkurse në botë, vetëm në Shqipëri. Në Gjeorgji mund edhe të vijë së bashku me mua në konkurs.

## Cili është personi që ju frymëzon gjithmonë në jetën tuaj?

Personi që më frymëzon dhe më ndihmon çdo ditë në stërvitjen

time është trajneri im, Zef Kovaçi. Ai është shoku, prindi, psikologu im. Në momentet që unë kam pasur në botë, vetëm në Shqipëri. Në Gjeorgji mund edhe të vijë së bashku me mua në konkurs. Durimi humb ndonjëherë, por duhet të insistosh. Njeriu e tregon veten në momentet e vështira. Ai më ka dhënë durimin dhe fuqinë për të ecur përpara.




Tashmë prej një kohe të gjatë, në mediat rozë është folur për një lidhje të mundshme mes Ronela Hajatit dhe Young Zerkës dhe së fundmi u tha se ata janë ndarë. Ndonëse çifti as nuk e ka mohuar apo pohuar si lidhjen dhe ndarjen e tyre publikisht, deklaratat e tyre kanë lënë të nënkuptuara se mes dyshes ka patur diçka dhe shpesh herë ngacmohet lidhur me këtë. I ftuar së fundmi në "Wake up", Zerka u pyet lidhur me raportin që ka me këngëtarën, ku me shaka tha që e ka gozë teze. "E kam goçë teze. (qesh). Me mua është i njëjti avaz, gjithmonë mediat thonë Zerka u lidh Zerka u zgjidh. Jemi shok shoqe, koleg shumë të mirë." , ka thënë ai teksa ka shtuar se shpreson që shoqëria e tyre të zgjasë shumë", ka thënë Zerka.



## "A jeni të lidhur?", Young Zerka i habi të gjithë: E kam thjesht shoqe

Së fundmi, Elhaida Dani ka udhëtuar Sdrejt Indonezisë me disa miq të saj muzikantë. Këngëtarja ka publikuar në rrjete sociale foto dhe video me pamje fantastike gjatë udhëtimit të saj. Në njërin prej tyre shihet nga lart qyteti i Dohas në Katar, pamjen e të cilit Elhaida duket se e ka shijuar shumë. Megjithatë dikush prej ndjekësve të saj ka vendosur ta prishë këtë moment me anë të një komenti që Elhaidës nuk i ka pëlqyer aspak. Në videon e publikuar nga këngëtarja dikush shkruante: "Bëja qejfin sheikut se të paguan mirë. Të rroftë vizita". Elhaidës nuk i ka kaluar pa i rënë në sy ky koment, ndaj ka reaguar ashpër ndaj tij. "Bravo! Sipas teje një femër të udhëtojë dhe të paguajë për jetën e saj ka nevojë për sheik? Më vjen keq për ty! Familja ime më ka edukuar ndryshe. Ju lutem, kemi nevojë të shohim jetën nga një tjetër perspektivë! Femrat s'kanë nevojë për 'mashkullin me lekë' për të udhëtuar apo jetuar jetën e ëndrrave të tyre!", - i është përgjigjur Elhaida. Këngëtarja më pas ka marrë edhe mbështetjen e fansave të saj, të cilët e dinë shumë mirë sa shumë punë i është dashur për të arritur këtu ku është sot.it.




## "Bëja qejfin sheikut se të paguan mirë", Elhaida Dani reagon ashpër ndaj komentuesit

Ai është një ndër reperët më të njohur në vend, ku ka korrur sukses edhe jashtë. Po flasim pikërisht për Mozzik, i cili ka treguar shpesh se ka kaluar një jetë të vështirë, por megjithatë ja ka dalë mbanë të bëjë realitet ëndrrat e tij. Së fundmi ai ka zbuluar disa të pathëna për jetën e tij që lidhen me arsimimin. Me anë të opsionit "Ask me a question", reperi ka treguar se ka filluar të merret me muzikë që në shkollë fillore. Ai ka zbuluar se ka vetëm 8 klasë shkollë, por mendon që më mirë do të ishte të kishte dhe arsimin e lartë. Kur dikush nga ndjekësit e ka pyetur nëse është më mirë me apo pa shkollë, ai u përgjigj: "Më mirë me shkollë normal, por fatkeqësisht më e madhe është se në Kosovë me diplomë të fakultetit duhet të mbash blloqe dhe kova me ilaç". Gjithashtu, ai u ka premtuar fansave të tij se shumë shpejt do të publikojë një album me muzikë cilësore. Mozzik tashmë është i martuar dhe baba i një vajze të quajtur Hana.



## Mozzik rrëfen për fëmijërinë: Kam 8 klasë shkollë, nisa karrierën në fillore

Ajo njihet si një ndër femrat më joshëse të muzikës shqiptare. Pavarësisht se ka kaluar shumë kohë, duket sikur ajo nuk ndryshon aspak në pamje edhe pse në shkurt festoi 42-vjetorin. Gjithnjë tërheqëse dhe sensuale në postimet që bën në Instagram, Ledina Çelo i mbush me zili të gjitha femrat. Kështu ka bërë edhe me postimin e fundit në 'Instastory', ku ka treguar se sot, bashkëshorti i ka përgatitur drekën. Sikur të mos mjaftonte fakti që ai e mban Ledinën në pëllëmbë të dorës, këngëtarja ka guxuar të na tregojë linjat e saj seksi. E sapo dalë nga dushi, me flokët ende të lagur, Ledina ka hapur rrobëde-shambër-in për të na treguar më shumë seç duhet. Kur shohim këto pamje ende nuk e besojmë dot që ajo është nënë e dy fëmijëve, një djali dhe një vajze, me Kick-Boksierin, Naim.



## Ledina Çelo poston videon provokuese e sapodalë nga dushi

# BULEVARDI

**POLITIK**

*Na merrni seriozisht!*

## Dreka, "gratë" e Fatos Nanos mblidhen bashkë

Ish-personalitetet e Partisë Socialiste në kohën kur kjo forcë politike drejtohej nga Fatos Nano janë mbledhur së bashku në një prej lokaleve në periferi të kryeqytetit (në Laknas) për të drekuar. Shumica e tyre kanë qenë deri në kryesinë e PS, madje edhe zv. ministre e Arsimit në Shqipëri dhe ish-in kryesisht emra të promovuara nga Fatos Nano. Jo vetëm kaq por edhe pasi Nano u largua nga drejtimi i PS-së ato janë treguar besnike ndaj tij, duke qenë gjithmonë një zë i fortë kundër kryetarit të ri socialistë, Edi Rama. Bëhet fjalë për emra të njohur publik, si ish-anëtarja e kryesisë së PS-së të Tiranës Eva Allushi, ish-deputetja Rajmonda Stefa Dimo, ish-deputetja dhe ish-kryetarja e Forumit të Gruas Socialiste, Natasha Paco, ish-zëvendësministrja e arsimit Edlira Haxhiymeri, apo edhe anëtarja e kryesisë së PS-së Saimira Pino. "Kur jemi bashkë nuk e shohim orën. Bashkë me verën shumë dashuri në tavolinë", - shkruan Allushi lidhur me këtë drekë.



## Erjon Braçe kishte ditëlindjen, ja deputetja që e uroi e para

Zëvendëskryeministri Erjon Braçe feston sot 47 vjetorin e lindjes, ndërsa që në mëngjes nuk kanë munguar edhe urimet jo vetëm nga qytetarë e zgjedhës të tij, por edhe kolegë në Kuvendin e Shqipërisë. E para që e ka uruar deputetin socialist, ka qenë deputetja e socialiste e Qarkut Fier, Antoneta Dhima. Ja çfarë i shkruan ajo Braçes në urimin e vet: "Do doja ta nisja ditën sot me një urim special, për një njeri special. Gëzuar këtë datëlindje, zoti zv.kryeministër. Edhe shumë vite të tjera sukses dhe arritje. Qofsh përherë energjik dhe i palodhur për të çuar përpara nismat e ndërmarra. Shumë urime miku im, Erjon Braçe". shtatzënisë.

## Xhelozia mes socialistëve, Kodheli: Punova 4 vjet për bazën ajrore të Kuçovës

Ceremonia e 10-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO ishte një moment i mirë për të shprehur mirënjohje për të gjithë ata që kontribuan, jo vetëm në anëtarësim të vendit tonë në aleancën më të madhe politiko-ushtarake në botë, por edhe për modernizimin e ushtrisë shqiptare. Një prej arritjeve të këtij anëtarësimi është pa dyshim edhe vendimi për të rindërtuar aeroportin e Kuçovës tashmë si një bazë moderne e NATO-s në Ballkan. Natyrisht vendimi u bë publik vitin që shkoi, por që për të arritur deri aty është bërë natyrisht një punë e madhe për vite të tëra, dhe ku duket se meritën kryesore e ka pasur Ministria e Mëparshme e Mbrojtjes. Dhe këtë fakt nuk nguron ta evidentojë vetë ish-ministrja Kodheli, e cila nëpërmjet një komenti në faqen e "Facebook" të deputetes Ermonela Felaj shprehet se ndihej krenare për punën e bërë prej 4 vitësh për këtë bazë. "Jam krenare që bashkë me kolegët e mij të Ministrisë së Mbrojtjes dhe SHP, megjithëse na u deshën thujse 4 vjet, ia mbërritëm t'i japim Kuçovës dhe gjithë Shqipërisë një projekt të madh siç e meriton një vend anëtar i NATO-s!", - shkroi Kodheli.



## Merkel i dhuron Manastirit të Assisit pjesë nga Muri i Berlinit

Një pjesë e Murit të Berlinit iu dhurua Manastirit të famshëm të Assisit në Peruxhia. Ajo u dhurua nga Kancelarja gjermane Angela Merkel për priftërinjtë e "Konventës së Shenjtë". "Është një objekt shumë i rrallë", shkruan zyra e shtypit e Konventës së Shenjtë. "Ajo vjen nga brezi i dytë i Murit të Berlinit, që u ndërtua në 1965 në shumë pjesë të ish-Republikës Demokratike gjermane", tha ajo. Fragmenti që mbërriti në Assisi ishte pikturuar nga artisti me inicialet S. H. E.K., një nga të parët që bëri mbishkrime me ngjyra në Murin e Berlinit.





## Këshilla

Nga Davide Algheri,  
Psikolog


Një çift, që të quhet i tillë, duhet të karakterizohet nga një ndarje e emocioneve mes njëri-tjetrit, nga seksualiteti dhe nga prezenca e një projekti të përbashkët në një dimension kohor. Këta tre elementë duhet të bashkëjetojnë në një ekuilibër dinamik, brenda një qarku ku secili nga të tre të ndikojë mbi tjetrin dhe ku, siç ndodh, njëri element mbizotëron mbi tjetrin. Në atë moment ku mungon ekuilibri dinamik, krijohet një disekuilibër që karakterizohet nga vuajtje dhe monotoni. Hyhet kështu në krizë, e cila mund të manifestohet (me grindje dhe përplasje) ose të jetë e heshtur (secili për hesap të vet).

## KRIZA

Është e mundur që të dallohen tri rrugëtime të ndryshme që variojnë në bazë të zotësisë së çiftit për të përpunuar ose jo iluzionin e për të kaluar nga një raport idilik (tipik në fazën e të të rënit në dashuri) në një raport realist dhe të pëkur.

## SHMANGIA E KRIZËS

Çifti hyn në krizë edhe për një arsye fiziologjike, nga iluzioni i të rënit në dashuri, kalohet në realitet dhe kjo gjë, ndonjëherë, e vë në diskutim çiftin, në përpjekjet për të shmangur zhgënjimin. Të humbësh iluzionin, për disa persona, rezultoi shkatërrimtar (mbaj iluzionin, por lë çiftin). Ka persona që kalojnë nga një rënie në dashuri në tjetër, pa kaluar limitin që i çon tek monotonia. Në këtë mënyrë ndërtojnë të tjera iluzione ose bëjnë gjoja sikur ekziston një realitet tjetër. Në të rënit në dashuri, elementët shqetësues, fshihen "poshtë tapetit", e ne shikojmë atë që duam të shohim. Ky mekanizëm, shpesh, mund të zgjasë për shumë kohë, duke krijuar kështu kriza të mëdha në momentin që realiteti imponohet brenda iluzionit (si p.sh lindja e një fëmije ose pasi fëmijët janë rritur dhe i rikthehesh çiftit). Ka çifte që e nxjerrin në sipërfaqe krizën përmes disa mekanizmave. P.sh duke gjetur një "të tretë" ku të spostojnë konfliktin e më të



## Kriza në çift? Ja si ta shpëtoni një marrëdhënie



cilin lidhin krizën ose duke u bashkuar kompaktë përballë një vështirësie (fëmijë problematik ose për t'u mbrojtur, vjehrra ose vjehëri, puna, i/e dashuri ku derdhet dëshira për të jetuar sërisht). Në këtë sens, tradhtia mund të jetohej si dëshitim, por edhe si një rast i mirë, për të tronditur sistemin e krizës. Në këtë rast, personi tjetër duhet vënë përpara një zgjedhje

të ndërgjegjshme. Në raste të tjera mund të dalë në sipërfaqe me një simptomë: duke mos folur sot me trup, flas me simptomë, si një shenjë e një raporti të sikletshëm. Shfaqet kriza, por nuk kam aftësinë për të dalë, shpesh edhe prej shumë kohësh. Është si majoneza që nuk "goditet". Në raste më të shumta, çiftet rrotullojnë majonezën, pa shtuar asnjë përbërës të ri,

e duke luajtur të njëjtin skenar e të njëjtin temë.

## RRETHI I ZHGËNJIMIT

Është një alternim i vazhdueshëm me zhgënjime dhe krizave në çift. Edhe në këto raste, partnerët nuk arrijnë të integrojnë imazhin e tjetrit në kokën e tyre dhe si pasojë mbesin të zhgënjyer. Shumë shpesh krizat në çift manifestohen me akuzë reciproke dhe imazhi që i përçojnë observuesit është i një raporti të kristalizuar, por ku janë bllokuar aftësitë e transformimit. Nëse nuk vihet energji, nëse nuk punohet, duhet pyetur tjetri se sa rëndësi ka raporti për të dhe sa rëndësi ka ndarja. Është me rëndësi të dihet se puna me çiftin për të kuptuar e për të ndryshuar çon

në dy drejtime, ose në një organizim të ri, ose në ndarje. Kjo sjell vuajtje, por në këtë rast ndarja nuk është një dështim por një ndërgjegjësim, por që duhet të dihet si të menaxhohet. Nëse kur jemi bashkë do të ishim të ndërgjegjshëm se çifti edhe mund të ndahet, ndoshta do të përpiqeshim më shumë e do të tregonim më kujdes.

## PRISHJA E ILUZIONIT

Koincidon me procesin e realitetit, me pranimin e tjetrit, jep mundësin që të vazhdojë lidhja ose të mbarojë përfundimisht. Në përgjithësi karakterizon çiftet që funksionojnë dhe kalohet nga një njohje e realitetit dhe zhgënjim, në një pranim të realitetit. Në këtë rast, të dy partnerët

munden të integrojnë pjesët e mira dhe të këqija të njëri-tjetrit, që më parë ishin të mjugullta. Në çiftet e shpejta, ka nxitim, sikur të mos kishin kohë. Kanë arsye emotive, por rrallë arrijnë të vendosin bazat për atë rritjen në kohë që jep prishja e iluzionit.

## SI TË DALËSH NGA KRIZA E SI TA MENAXHOSH ATË?

Duhet të flisni për veten, jo për të e as për ne. Është e nevojshme që të keni dëshirën për të krijuar një ndryshim, në vetvete. Mendohuni! Juve çfarë ju tërheq dhe çfarë ju tërhiqte tek partneri? Shpesh, elementët fillestarë, ato të njohjes, që na shqetësonin e bezzdisnin, ata kthehen në elementë shqetësues dhe në fund.

BOTIMI

# DAVID SELENICASI

## Pikturat kishtare të murgut vlonjat

Fatmira Nikolli

Libri i Ahilino Palushit na njeh me një nga piktorët më interesantë të periudhës pasbizantine

Piktura kishtare pasbizantine e shekullit të 18-të dhe 19-të në Ballkanin osman, vetëm në 20 vitet e fundit filloi të tërheqë gjithnjë e më shumë interesin e ekspertëve.

Dr. Ioannis Vitaliotis nga Qendra e Kërkimeve mbi Artin Bizantin dhe Pasbizantin e Akademisë së Athinës thotë se nuk do të ishte ekgzagjuar nëse do të thuhej se kjo periudhë e vonë e pikturës post-bizantine konsiderohej si diçka që nuk ia vlen të studiohej hollësisht.

Shënimi i Vitaliotis botohet si parathënie në librin e Dr. Ahilino Palushi, një monografi që Aleksandër Meksi e quan dinjitoze me titull "David Selenicasi - piktori i rilindjes pasbizantine në Shqipëri", botim i OMBRA GVG 2018. Meksi e ilustron me kopertinën dhe skenën "Vallja nga narteksi i kishës" së Shën Mëri Kukuzelit në Manastirin e Lavrës së Madhe në Malin e Shenjtë e pikturuar 1715.

Dr. Ioannis Vitaliotis thotë se në kuadrin e interesit, relativisht të kohëve të fundit, për pikturën pasbizantine të vonë, libri i Ahilino Palushit vjen për të plotësuar një boshllëk të rëndësishëm. "Studimi i tij ka të bëjë me punën e një piktori ikonash, i cili deri tani nuk ka qenë tërësisht i njohur nga ana e historisë së artit, murgut David, me prejardhje nga Selenica e Vlorës. Në një formë të parë, ky studim i miratua nga Universiteti i Tiranës si disertacion doktorature". Sipas mbishkrimeve, Davidi aktivizohet midis viteve 1715 dhe 1727 dhe, siç do ta konstatojë edhe lexuesi, nuk përbën rastin më të zakonshëm në pikturën pasbizantine. Ai vjen nga skajet perëndimor i botës pasbizantine, konkretisht nga një rajon, i cili në atë kohë ishte në një masë të konsiderueshme i islamizuar. "Për më tepër, kjo zonë nuk ishte dalluar si qendër e kultivimit të pikturës kishtarë, siç janë, për shembull, Agrafa, në Greqinë qendrore, ose siç janë fshatrat e malit të Gramozit. Megjithatë, jo vetëm që Davidi u bë një piktor i shquar, por, me sa duket dhe falë qëndrimit të tij në Malin Athos, mori përsipër dekorimin e kishave të mëdha urbane, si Shën Kollit në Voskopojë [1726], në çdo aspekt puna e tij më e lartë, dhe Shën Mëria "e Re" (Nea Panaghia) në Selanik [1727]. Pika më e rëndësishme e artit të Davidit është se i përket një rryme të shkurtër të pikturës pasbizantine, e cila mund të përshkruhet si "neo-panseline", sipas emrit të artistit legjendar Manuel Panselino", shkruan në parathënie Dr. Ioannis Vitaliotis.


Profesorin vë në dukje se përfaqësuess më i shquar e kësaj rryme ka qenë murgu athonit Dionisi nga



Furna e Agrafës [1670-1744], fama e të cilit i detyrohet kryesisht manualit "Interpretimi i Artit të Pikturës" (Hermeneia tes Zogra kes Tehnes). Ai thekson se në realitet, kjo punë bazohet në tekste të mëparshme me përmbajtje të ngjashme. Meqenëse "Interpretimi" i Dionisit u botua në vitin 1909 në Shën Petersburg nga dijetari grek Antonios Papadhopoulos-Kerameus, përbente një material të klasit të parë për njohjen e ikonografisë së bizantine, në një kohë kur studimi i artit bizantin sapo kishte filluar. Nga ana tjetër, Dionisi ishte një piktor "ideolog", me shqetësim estetik. Dr. Ioannis Vitaliotis thyotë se dëshira e tij e madhe ka qenë rigjenerimi i pikturës kishtarë të "thatë". Si model ai përdori afresket e shkëlqyera të kishës së Protaton, Katedrales së Malit të Shenjtë, e pikturuar rreth 1300. Në traditën gojore athonite të shek. XVIII, ato u atribuoheshin Manuel Panselino-it. Sot dimë se dekorimi i Protaton është punë e Mihael Astrapas dhe Eutihit, piktor të famshëm nga Selaniku bizantin.

### 3 DHUNTITË E DAVID SELENICASIT

Dr. Ioannis Vitaliotis shkruan në parathënie se David Selenicasi bën pjesë në një lëvizje "rilindjeje" artistike, e cila nuk orientohet sipas modeleve perëndimore të kohës, por, në të kundërt, kthehet në të kaluarën "e lavdishme" athonite dhe bizantine. Sipas studiuesit nga Qendra e Kërkimeve mbi Artin Bizantin dhe Pasbizantin e Akademisë së Athinës, përfaqësuesit e kësaj rryme nuk refuzojnë të importojnë në krijimet e tyre motive të kohës që i përkasin estetikës së "rokokoit oriental" ose "barokut turk". Në fakt,



këto modele mbërritën nga Evropa perëndimore dhe qendrore në territorin Osman (së pari në Stamboll) dhe shfrytëzohen në mënyrë krijuese nga artistët vendas, qoftë të krishterë apo myslimanë. Me fjalë të tjera, Davidi është eklektik: Ai kërkoi me vetëdije burimin e frymëzimit të tij në "artin e madh" të së kaluarës "së tij" dhe, në të njëjtën kohë, zgjerohet me kujdes në disa risi perëndimore. "Përfundimisht, piktori ynë duhet të shihet në kontekstin kulturor të Ballkanit në gjysmën e parë të shek. XVIII, kohë kur "enciklopedizmi" dhe Iluminizmi perëndimor fillojnë të dërgojnë me ngurrin reflektimet e tyre në popullsitë ortodokse të Lindjes Osmane. Libri i Ahilino Palushit ka tre dhuntia të mëdha. Dhuntia e parë konsiston në faktin se përbën monografinë e parë të hartuar për veprën e David Selenicës, si një e tërë. Piktura e Davidit shqyrtohet sipas monumentit, kishë apo ikona, me

përfundime të zgjeruara dhe me material bibliografik të mjaftueshëm", vëren Vitaliotis. Ai thekson se është shumë i rëndësishëm fakti se në librin e Palushit, arrihet ekuilibri i nevojshëm midis prezantimit të hollësive dhe pamjes së përgjithshme. "Diçka e tillë, nëse vërejmë sasinë e madhe të materialit të paraqitur, të botuar dhe të pabotuar, nuk është aspak e lehtë. Merita e dytë e këtij libri ka të bëjë me mundësinë që i jepet publikut shqiptar artdashës për t'u njohur me një nga piktorët më interesantë të periudhës pasbizantine që ka treguar Shqipëria, me aktivitet që përshin tre vendet fqinje, Shqipëri, Greqi dhe IRJ të Maqedonisë. Në studimin e tij, Ahilino Palushi nuk e sheh David Selenicën si një përfaqësues të ndonjë 'shkollë të pikturës shqiptare', por e shqyrton atë në kuadrin më të gjerë të traditës artistike pasbizantine së fillimit të shek. XVIII dhe, njëkohësisht, në kuadrin më të ngushtë të rrymës 'neo-panseline', nënvizon Vitaliotis. Natyrisht, thotë ai, diçka e tillë nuk e çon autorin të lërë pas dore disa elemente me karakter lokal, të cilat shfaqen në veprën e këtij piktori të aftë. Dhuntia e tretë e librit të Ahilino Palushit, të cilën do të doja të theksoja në mënyrë të veçantë, është se edhe pse autori filloi të merrej me studimin e pikturës pasbizantine në moshë të pjekur, fakti që ai është profesor i arteve në Liceun Artistik 'Jordan Misja' e pajis atë me një njohuri të veçantë intuitive. Kjo është veçanërisht e dukshme në faqet që i dedikohen analizës stilistike, ku Ahilino Palushi arrin të perceptojë fazat e evolucionit dhe përkurën artistike të Davidit. Së

fundmi, vetë lexuesi do të ketë mundësinë të vlerësojë vërejtjet e mësipërme dhe rëndësinë e këtij studimi. Nga ana ime, me gjithë zemër do të dëshiroja jo vetëm një vazhdimësi të frytshme të punës së Ahilino Palushit rreth pikturës kishtarë në Shqipëri, por edhe botimin e studimeve të reja të ngjashme në gjuhën shqipe, e cila, më lejoni të them, është veçanërisht e dashur për mua", shënon Vitaliotis për librin e Palushit.

Më herët, ai bën me dije se njohuria e akumuluar nga studimi sistematik i pikturës kishtarë ortodokse të shek. XVI dhe XVII luajti një rol të rëndësishëm në rivlerësimin e fazës së fundit të pikturës pasbizantine. Faktor vendimtar ka qenë, gjithashtu, interesi i shkaktuar nga ikonat e shtypura në letër, të cilat deri në atë kohë përcmoheshin. Këto imazhe fetare, të bazuara në gravura, luajtën rol parësor në formimin e pikturës kishtarë të shek. XVII dhe XIX. Diçka e tillë, tashmë, nuk konsiderohet më si rënie e një tradite shekullore, por si një ngjarje artistike me shumëllojshmëri ngjyrash dhe dinamike, e lidhur ngushtë me zhvillimet shoqërore brenda millet-it ortodoks të Perandorisë Osmane: gjithashtu, trajtohet si një lidhje midis artit vizual ortodoks tradicional dhe modernitetit.

### STUDIMET PËR SELENICASIN

Viktori Puzanova, është studiuesja e parë, e cila pasqyron punën e piktorit David nga Selenica, të realizuar në bazilikën e madhe të Shën Kollit në Voskopojë, me ndihmën edhe të Kostandinit dhe Kristos. Puzanova, e shkëput veprën e këtij autori nga një "numër i madh piktorësh më të vegjël, që kanë mbuluar me piktura murale kisha të mëdha dhe të vogla të Voskopojës". Studiuësja, duke nxjerrë në pah karakteristika të punës së tij si mjeshër, e veçon atë si një piktor të madh, i cili ka kryer studime të mira në pikturë. Ajo e vazhdon më tutje arsyetimin, duke shprehur bindjen se Davidi ka studiuar në një shkollë artistike të ndonjë qendre të madhe 3, pasi një mundësi e tillë ishte thuar se pamundur për vendin tonë në atë kohë. Pavarësisht superlativave dhe nxjerrjes në pah të rëndësishme këtij "fenomeni", në artin e asaj periudhe në vendin tonë, Viktori Puzanova, nuk thellohet më tej në dhënie e të dhënave rreth origjinës dhe veprimtarisë së piktorit. Një analizë më të plotë rreth këtij mjeshëri "freskograf", na sjell vite më vonë studiuesit tjetër i apasionuar Theofan Popa. Në studimin e tij, jepet një përshkrim i përgjithshëm i programit ikonografik dhe i stilit të përdorur nga Davidi, në afreskun e kishës së Shën Kollit në Voskopojë, Popa hedh edhe disa hipoteza të rëndësishme rreth origjinës së piktorit, shkollimit dhe veprave të tjera të realizuara prej tij, brenda dhe jashtë vendit

## DEBATI

# "Duhet një ligj me sanksione për gjuhën"

Nga prof. Rami Memushaj

Është hera e dytë këtë vit që kryeministri i vendit shpreh shqetësimin për "një situatë të përgjithshme dramatike me gjuhën shqipe në tërësi", duke propozuar si masë për kapërcimin e kësaj gjendjeje futjen e mësimit të gjuhës amtare edhe në universitet. Ky deklarim i tij është pritur me kritika ideologjike jo vetëm nga politika, po edhe nga akademikë të fushës, për të cilët "futja e mësimit të gjuhës amtare në universitete nuk është zgjidhja", pasi mësimi i saj është detyrë ekskluzive e arsimit parauniversitar.

Nuk mund të mohohet se mësimi i gjuhës amtare është detyrë e arsimit parauniversitar, por, nga ana tjetër, nuk duhet harruar se zotërimi i gjuhës amtare - dhe këtu nuk është fjala për dialektin, po për gjuhën standarde, e cila është diçka jo e trashëguar - nuk mbyllet me përfundimin e shkollës së mesme. Në shkollën 9-vjeçare dhe të mesme merren njohuri për sistemin gramatikor të gjuhës standarde, mësohen norma morfologjike, drejtshkrimore dhe pikësimi i saj si dhe punohet për t'i pajisur nxënësit me shprehje të përdorimit të gjuhës në të folur e të shkruar. Por për vetësimin i gjuhës standarde vijon edhe pas përfundimit të shkollës së mesme, kur të rinjtë nëpërmjet shkolimit universitar përgatiten për të punuar në specialitete të ndryshme, të cilat kanë edhe "zhargonin" e tyre, terminologjinë e veçantë dhe stilin karakteristik të fushës. Nuk është e vështirë, për shembull, të shihet ndryshimi midis gjuhës së publicistikës, të filozofisë, të jurisprudencës dhe të shkencës. Dhe për ta përdorur gjuhën në këto fusha, specialistët duhet të përgatiten nga shkolla e lartë.

Për t'u bindur për këtë, le të shohim përvojën këndeje dhe përtej Atlantikut. Në Europë, që prej vitit 1995, shoqata europiane AESOP (Association of European Schools of Planning) publikoi një dokument me kërkesat bazë për edukimin universitar, i cili është një "kurrikulum bazë" që këshillohet ta ndjekin shkollat e larta të kontinentit, pavarësisht specialitetit të zgjedhur nga studenti. Ndër tri kërkesat themelore të këtij kurrikulumi bazë është që studentët të fitojnë kompetencë praktike për disa fusha dhe një prej këtyre kompetencave që duhet të fitojë studenti në shkollën e lartë, është aftësimi në "komunikimin e shkruar, të folur dhe grafik". Për ta fituar këtë kompetencë, studenti duhet të ndjekë kurse universitare të gjuhës. Përtej oqeanit, Shoqata Amerikane e Kolegjeve dhe e Universiteteve shpalli në vitin 2005 nismën për përgatitjen e studentëve amerikanë për shekullin XXI, duke synuar pajisjen e tyre me aftësitë intelektuale dhe praktike për kërkim dhe analizë, për mendim kritik dhe krijues, për komunikim me shkrim e me gojë, për të punuar në grup për zgjidhjen e problemeve etj. Aftësinë për komunikimin me shkrim



Rami Memushaj: Kujdesi për gjuhën standarde si detyrë e shoqërisë shqiptare

dhe me gojë studenti amerikan e merr duke ndjekur kursin njëvjeçar "Shkrim universitar" (University writing), që i ndihmon ata të shkruajnë ese, raporte pune etj., pra një kurs me të cilin ngjan pak a shumë lënda "Shkrim akademik" që zhvillohet në disa degë të universiteteve tona.

Në dritën e përvojës botërore, po edhe sonës, vijimi i mësimit të gjuhës amtare edhe në universitet është një gjë e domosdoshme. Për këtë arsye nisma e kryeministrit për futjen e mësimit të gjuhës shqipe në shkollën e lartë duhet vlerësuar si një rast i artë që duhet mbështetur nga departamentet e gjuhës shqipe dhe gjuhëtarët shqiptarë. Tjetër gjë është përmbajtja dhe kohëzgjatja e kursit, të cilat përbëjnë probleme teknike që duhet t'i zgjidhin departamentet e gjuhës shqipe në marrëveshje me njëri-tjetrin. Suksesi i kësaj nisme

Nuk mund të mohohet se mësimi i gjuhës amtare është detyrë e arsimit parauniversitar, por, nga ana tjetër, nuk duhet harruar se zotërimi i gjuhës amtare - dhe këtu nuk është fjala për dialektin, po për gjuhën standarde, e cila është diçka jo e trashëguar - nuk mbyllet me përfundimin e shkollës së mesme.

do të varet në shkallë të madhe nga serioziteti me të cilin do ta zhvillojnë këtë lëndë pedagogët e gjuhës shqipe, që nuk duhet të shkojnë në mësim me një gazetë nën shtetull, por pas një përgatitje serioze, që nënkupton jo vetëm përdorimin e doracakeve gjuhësore, por edhe njohjen e terminologjisë e të veçorive të stilit të fushës përkatëse.

Sigurisht, nuk mund të mendohet që me futjen e mësimit të gjuhës amtare në universitet do të zgjidhet problemet që shfaqen sot në ligjërimin publik të shkruar e të folur. Ky hap do parë vetëm si një masë në vargun e masave që duhet të marrë qeveria për rritjen e kulturës gjuhësore dhe të përgjegjësisë së konsumatorëve të mëdhenj të gjuhës, siç janë shtëpitë botuese, redaktësit e gazetave dhe të televizioneve, administrata etj. Që të kapërcehet kjo gjendje e pakënaqshme që ka shqetësuar prej kohësh gjuhëtarët, po deri edhe politikanë e artistë me emër, duhet që këta konsumatorë të gjuhës të detyrohen me ligj të zbatojnë normat e gjuhës standarde, pra duhet miratuar një ligj për gjuhën, me sanksione për shkeljet e këtyre normave. Kujtojmë se më parë kryeministri ka folur për vendosjen e korrektorëve letrarë, por kjo mbeti vetëm një dëshirë. Pra, problemet nuk zgjidhen me zgjidhje të pjesshme dhe as me voluntarizëm, me dëshirën subjektive të një individ, i cili nesër mund të mos jetë në pozitën që është sot dhe, si rrjedhim, nisma e tij të shembet. Vlen të kujtojmë se, pas botimit më 1973 të "Drejtshkrimit të gjuhës shqipe", në janar 1974 Këshilli i Ministrave nxori vendimin "Mbi masat për zba-

timin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe", i cili ngarkonte Ministrinë e Arsimit që çështjet e lidhur ma normën e gjuhës letrare të pasqyroheshin në testet shkollore, që të kualifikoheshin mësuesit dhe punonjësit e shtypit, që mjetet e shkruara e të folura të informimit të zbatonin normat e gjuhës letrare, që në institucionet qendrore të kishte redaktorë gjuhësorë etj. Nuk ka pasur asnjë arsye që ky vendim të mos zbatohet edhe pas viteve 90 dhe të shërbente si bazë për një ligj më të plotë për gjuhën.

Për përmirësimin e gjendjes në zbatimin e normave të gjuhës letrare, Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare para 3-4 vjetësh i propozoi Ministrisë së Informacionit një paketë masash që duhet të merrte shteti, si hartimin e një VKM-je për zbatimin e normës letrare dhe të rregullave gjuhësore në veprimtarinë e administratës së shtetit, në entet botuese dhe në mediet; për zbatimin e detyruar të alfabetit shqip me 36 shkronja; për tregtimin e pajisjeve kompjuterike (tastiera, laptopë) me shkronjat çq e ëë dhe pajisjen shkallë-shkallë me to të institucioneve; për shkarkimin në kompjuterë e administratës së shtetit të programit drejtshkrimor AS.2 dhe instalimin e "Fjalorit elektronik të gjuhës shqipe"; që doktoratat, botimet elektronike a në letër të kishin emrat e redaktorit letrar dhe të korrektorit letrar të licencuar, kush pa të cilin të mos lëshohej ISBN-ja ose ISSN-

ja; që pranë ministrive përkatëse të ngriheshin grupe pune për standardizimin e emrave të përveçëm të njerëzve dhe të emrave geografikë si dhe për shkrimin e tabelave etj.; që nga Akademia e Shkencave, në bashkëveprim me Institutin e Gjuhësisë dhe departamente a qendra të informatikës, të kërkohen rrugë të zbatimit të teknologjisë kompjuterike dhe të informacionit në mësimdhënien dhe nxënien e shqipes. I ngritëm këto probleme edhe në tryezën e rrumbullakët të organizuar vitin e kaluar nga Biblioteka e Kryeministrit në ditën e gjuhës amtare, po edhe pas kësaj nuk u mor asnjë përgjigje.

Një shpërfillje e tillë për gjuhën amtare, tiparin tonë dallues kryesor, është e pafalshme. Asnjë komb nuk sillet kështu me gjuhën e vet. Për të mos shkuar larg, Maqedonia e Veriut ka ligj për maqedonishten, që është gjuhë me rreth një milion folës. Madje, në këtë shtet, pas miratimit të ligjit për gjuhën shqipe, është krijuar një agjenci për emërtimet shqip të institucioneve zyrtare, të tabelave e të rrugëve, e cila ka vënë në punë gjuhëtarët shqiptarë të atjeshëm.

"Mos e braktisni gjuhën" këshillon sociolinguisti i njohur amerikan Joshua Fishman, në përgjigje të thirrjes për ta lënë gjuhën në fatin e vet. Gjuha letrare nuk është e lindur, ajo është një krijim inxhinierik dhe si e tillë ka nevojë për kujdesin e përhershëm të shoqërisë, dmth. të shtetit.

Problematika që lidhet me përvetësimin e gjuhës letrare dhe zbatimin e normave të saj në veprimtarinë ligjërimore, është shumë e gjerë dhe e tillë që suksesi në një hallkë nuk siguron suksesin e gjithë sipër marrjes. Ajo kërkon patjetër ndërhyrjen e shtetit, që, për të ndërtuar një politikë gjuhësore efektive, duhet të bashkëpunojë me Akademinë dhe me institucionet gjuhësore. Madje, ky bashkëpunim duhet edhe në shkallë ndërshtetërore, pasi problemet me gjuhën shqipe janë të njëjta edhe në Kosovë, edhe në Maqedoninë e Veriut. I domosdoshëm është ky bashkëpunim sidomos në punë të terminologjisë, për të pasur një terminologji të njësuar, po edhe për pastrimin e gjuhës nga fjalët e huaja dhe pasurimin e saj me fjalë vendi. Është e nevojshme ngritja e një këshilli kombëtar me përfaqësim të tri njësive shtetërore për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës, siç që Komisioni i Përhershëm për pasterëritë e gjuhës, e që u krijua me vendim të Këshillit të Ministrave më 1979 dhe vijoi deri më 1990, i cili kishte si detyrë punën "për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës", "për shqipërimin dhe njësimin e terminologjisë tekniko-shkencore" dhe kujdesin "për zbatimin e plotë të normës së gjuhës letrare".


Opinion i Ditës

# Bobo, çfarë i kemi bërë vetes ne shqiptarët?!

Nga Xhevat MUSTAFA

(vijon nga faqja 1)

... piramidale", u publikua një "lajm bombastik", të paktën për Ballkanin. Sipas një studimi ndërkombëtar, me nivelet e larta të martesave, lindshmërisë, rritjes së popullsisë dhe me nivelet e ulëta të vdekshmërisë, me mbizotërimin e moshave të reja në përbërjen e përgjithshme të popullsisë, shoqëruar paralelisht me plakjen dhe mpakjen e popullsisë në Serbi e Greqi, aty nga viti 2050, "shqiptarët mund të bëhen populli më i madh në Ballkan", me rreth 7-8 milionë frymë. Sipas natyrës sonë si popull, "harruam" se ky parashikim, që na kishte lumturuar neve, kishte hidhëruar dhe shqetësuar fqinjët tanë serbë, grekë, maqedonas, malazezë... Në këto kushte, me shumë gjasa secili më vete, i vunë gishtin kokës, vranë mendjen dhe bënë strategji se si ta parandalonin këtë "gjëmë". Strategjitë e tyre të reja, mbi stokun e atyre të vjetra e të mykura, mund të jenë ose jo në letër, por, gjithsesi, nga faktet e panumërt të këtyre rreth 25 vjetëve të shkuar... Shumica e tyre do të bazoheshin në hapësirat, mundësitë, resurset, kushtet e favorshme që do të "falnin" vetë...shqiptarët. Alternativa e forcës dhe e luftës, e sulmit dhe pushtimit me ushtri, nuk mund të merrej më në konsideratë dhe të zbatohet. Ishte e konsumuar, shumë e kushtueshme, me humbje të mëdha jetësh njerëzore edhe nga ana e popujve të tyre. Njëkohësisht, merrej me mend se do të kishin kundërshtime të shumta e të forta nga shumica e fuqive të mëdha botërore dhe e organizatave më të fuqishme ndërkombëtare, dëme në imazhin rajonal dhe botëror. Kuptohet se kundërvënia e tyre mund të konkretizohej me masa të rënda dhe shumëformëshe ndëshkuese. Kështu që mbetej si alternativa më e mirë, më e mundshme, më pak e kushtueshme dhe shumë më pak konsumuese dhe e rrezikshme ajo e sprovuara, e "Kalit të Trojës", e marrjes nga brenda të "kalasë shqiptare". Edhe më e gëzueshme për ideuesit apo hartuesit e këtij skenari ishte se në "barkun e "Kalit të Trojës" të tyre, të kohës moderne, nuk do të futeshin dhe rrezikoheshin ushtarë serbë e grekë...Rolin dhe punën e tyre do ta bënin vetë...shqiptarët. Më troç apo shqip fare, fjala është për bler-



jen, financimin, sponsorizimin shumëformësh të tufave apo krerëve nga kopeja e politikaneve, qeveritarëve, biznesmenëve, shkencëtarëve, gazetarëve... shqiptarë nga gjaku dhe pasaportat...Për fatin e mirë të fqinjëve tanë dhe të aleatëve të tyre të lashtë e të sotëm, tregu i spinëve, mercenarëve, misionarëve në Shqipëri është edhe i pasur si frymë apo koka, edhe i lirë si fatura. Mjafton të kujtojmë vetëm një rast më të freskët. Sipas gazetës sonë "Shekulli", të dt.22.10.2018, që i referohet gazetës së njohur investigative greke, "iefimerida.gr", nëpërmjet Fondit Sekret të Kotzias me kodin 0896, rezultat se, "15 milionë euro janë përdorur në Shqipëri për pagesat e mediave, politikanëve, partive, shoqatave, etj., për propagandën filogreke dhe antishqiptare". Merret me mend se miliona të tjerë duhet të jenë dhënë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga shërbimi informativ grek, nga ministria e mbrojtjes...Me shumë gjasa, po kaq apo edhe shumë më të larta, duhet të jenë faturat e financuara apo të dhuruara nga Serbia. Sipas gjykimit tim edhe firmat pi-

ramidale dhe "fryti i tyre", 1997-ta, genocidi tejet masiv dhe barbar ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë më 1998-1999, ishin pjesë e këtij skenari. Megjithatë ai do të vazhonte frontalisht dhe pa u ndalur. Së pari, Shqipërisë me nën dhe mbitorë shumë të pasur i duheshin djegur dhe bërë sa më shumë të pavlefshme apo të paeftkshme për zhvillimin dhe fuqizimin e saj ekonomik, social, ushtarak...këto resurse. Bashkë me këto edhe shumçka e vlefshme dhe e shfrytëzueshme nga trashëgimia e periudhës komuniste, sidomos industria mekanike, ushqimore, tekstile si dhe në formën e armatimeve ushtarake, si tanke, avionë, artilleri, uzina, shitur thuajse badiava apo me çmime fare të ulëta për uzinat e metalurgjike në Malin e Zi apo të Kurumit në Elbasan... Domethënë nafta, mineralet, pyjet, pemëtaria dhe industrinë e lidhura me ato, privilegjet apo avantazhet e motit, detet, turizmin me mundësi për shfrytëzim gjithëvjetor...nuk duhej të lejoheshin ta bënin Shqipërinë një Zvicër në Ballkan, siç e kishin dashur shumë herët shqiptarët e vdekur dhe siç e kishin kërkuar shqiptarët e gjallë në pro-

"...me këtë tablo dhe me këto shifra e fakte, bëhet e qartë se parashikimi apo ëndrra jonë për t'u bërë populli më i madh në Ballkan, "u vra" apo "u mbyti" në barkun e nënës dhe "u varros për së gjalli"... Atëherë, logjikshëm, mund të shtrohet pyetja: nga kush e kemi më shumë këtë gjëmë, që nga "parajsë" natyrore prej Zotit, Shqipëria të bëhet një "ferr tokësor" për robt e saj? Nga fqinjët apo nga vetvetja?"

Një rrugë tjetër shumë e suksesshme për realizimin e skenarit hipotetik dhe real serbo-grek për të mos lejuar "tsnunamin demografik shqiptar" mbi ata, ka rezultuar të jetë dhe duket qartësisht se është, masivizimi dhe rritja e nivelit të korrupsionit në ekipet politike dhe qeverisëse, shoqëruar paralelisht me varfërimin masiv dhe ekstrem të qytetarëve të thjeshtë, me papunësinë e lartë tek moshat e afta për punë dhe sidomos tek moshat e reja...Por, për këtë qëllim ka shërbyer edhe "agresiviteti", më së shumti fals apo i shtirë mes dy kraheve të politikës; destabiliteti politik thuajse 28 vjeçar, i përforcuar sidomos në prag të ngjarjeve të mëdha për proceset integreuese të vendit si anëtarësi në NATO, liberalizimi i vizave, marrja e statusit të vendit kandidat për në BE, hapja e negociatave me atë... Kuptohet se të gjitha këto, pra mungesa e strategjive dhe programeve shkencore dhe afatgjata për shfrytëzimin sa më të lartë të pasurive të shumta natyrore; rritja e vazhdueshme e papunësisë, varfërisë, nivelet e ulëta të pagave dhe pensione ve si dhe të mbështetjes sociale për njerëzit në nevojë dhe fëmijët, e nivelit të korrupsionit dhe kriminalitetit shumëformësh; kanë sjellë masivizimin tek shqiptarët të bindjes se "këtu nuk jetohej, nuk bëhet shtet, demokraci, mirëqenie, jetë e vërtetë janë bllokuar dhjetëra tonë mishra për groposje importuar nga Brazili apo miellra e vajra të skaduar ardhur nga Serbia e Greqia, por qindra e mijëra tonë të tjerë kanë mundur të kalojnë nga doganat shqiptare dhe të futen në tregjet tona. Po kështu, nëpër depot e barnave dhe nëpër farmacitë dhe spitalet shqiptare, duhej të futeshin dhe janë futur karvanë me maune mbushur me barna ose të skaduar prej vitesh dhe krejt pa efekte lehtësuese e jo më shëruese, ose me cilësi të dobët dhe me efekte të shumta anësore... Sipas një informacioni fare të freskët nga BIRN, që i referohet edhe hetimit të nisur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, publikuar më 13 mars 2019, "vlera e medikamenteve të skaduar të bllokuara në farmacinë qendrore të QSUT arrin shumën e 7 milionë eurove". Vetëkuptohet se barna të tilla kanë sjellë rritjen sëmundshmërisë dhe të vdekshmërisë tek të gjitha moshat në Shqipëri; mbipopullimin e spitaleve publike dhe shtetërore; masivizimin e sterilitetit e të divorceve si dhe të mungesës së dëshirës nga moshat e reja për lindje serioze, për martesë, për lindje të shumë fëmijëve...



Opinionimi i Ditës

# Çlirimi i shtetit nga kapja dhe kriminalizimi, përmes votës së lirë, kryekauzë e qartë e opozitës

Nga Petrit Vasili

(vijon nga faqja 1)

... vetëm e vetëm një: çlirimi i shtetit nga kapja dhe kriminalizimi përmes votës së lirë.

Ringritja e shtetit në të gjitha nivelet e tij dhe rivendosja e standardeve bazike të zhëbra të demokracisë vetëm e vetëm përmes votës së lirë, pa të cilat ky shtet s'mund të ekzistojë e funksionojë më asnjë çast është imperativa e madhe, të cilës opozita i është përkushtuar tërësisht dhe pa kthim pas.

Asnjë reformë nuk mund të implementohet mbi një ngrehinë të tillë të kalbur shtetërore dhe asnjë iluzion, qoftë ky edhe qëllim mirë nuk mund të ushqehet për këtë. Themeli i të gjithë ngrehinës shtetërore është Republika Parlamentare, e cila është rrënuar e kapur tërësisht nga blerja e votës prej krimi të organizuar.

Ringritja e Republikës Parlamentare duke luftuar pa asnjë kompromis blerjen e votës përmes krimi nga rilindja është misioni i parë, i dytë, i tretë pra kryemisioni i patjetërsueshëm i opozitës. Dje-gia e mandateve ishte rruga e vetme, zgjidhja e vetme dhe reagimi i vetëm përballë një demokracie, që shkatërohet e rrënohet dhe një shteti, që kapej e asgjësohet nga rilindja si produkt kriminal i pruar i zgjedhjeve të kriminalizuara.

Kjo republikë dhe ky parlament i kalbur, që qelbet era krim s'mund të pëllë veçse drejtësi të kapur dhe mundësi zero për një reformë të drejtësi të paanshme politikisht, por edhe për çdo reformë tjetër, qoftë kjo ekonomike e shoqërore.

Çdo iluzion për një zbatim të drejtësi të paanshëm të reformës në drejtësi, apo edhe i çdo reforme tjetër është thjesht një iluzion i rremë, i paqenë dhe jashtë realitetit



në rastin më të mirë. Pas bllokimit nga rilindja të çdo mekanizmi parlamentar për të futur sërish reformën në drejtësi në dimensionin kushtetues të 21-22 korrikut 2016 dhe refuzimit arrogant në parlament nga rilindja të paketës së ndryshimeve për reformën në drejtësi të paraqitur nga opozita, përfundimisht u asgjësua çdo mundësi institucionale e shpëtimit të reformës në drejtësi nga kapja.

Dhe denoncimet e përditshme të një vetingu në drejtësi me dy standarde, si dhe mbushja e KLP dhe KLGJ me njerëz me rekorde të errëta të kontestuar edhe nga vetë ndërkombëtarët e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit të Reformës në drejtësi shuajnë çdo iluzion të së ashtuquajturës "drejtësi të re" dhe provojnë qartë se kapja nga rilindja është bërë kanceri, që po ha shtetin.

Një mazhorancë, që shkatëron të gjitha mekanizmat e kontrollit demokratik dhe qytetar mund të

përballet vetëm me mekanizmat asimetrike shumë të forta të qëndrësës politiko-qytetare pa kthim.

Çdo sofizëm i kujtdo, që i largohet këtij realiteti tragjik për demokracinë është pa asnjë vlerë.

Çdo sugjerim i llojit pseudoinstitucional, që opozita duhet gjoja të luftojë për reforma gjithfarësh, pa zgjidhur zemrën e problemit dhe nënën e të gjitha të këqijave, shitblerjen e votës, do të ishte thjesht një alibi për regjimin kriminal të rilindjes.

Çdo sugjerim a këshillë jashtë demaskimit të korrupsionit që ka kapur çdo qelizë të shtetit, demaskimit të kapjes dhe asgjësimit e parlamentit, të kapjes së drejtësisë, të rilindjes së mbjelljes masive të drogës, të trafikantëve, krimi të organizuar dhe pastrimit të parasë që sundojnë anë e mbanë, do të ishte një sugjerim a këshillë naivë në rastin më të mirë dhe e kapur edhe ai nga rilindja në rastin më të keq, nondone personalisht besoj shumë më shumë

se është kjo e fundit.

Opozita është shumë e qartë në kryekauzën e saj si edhe në diskursin e objektivin e saj për të çliruar shtetin nga kapja dhe kriminalizimi dhe për të ringritur shtetin e së drejtës dhe Republikën Parlamentare.

Çdo instrument në funksion të kësaj kauze, përfshirë djegjen e mandateve, është në funksion të një vizioni tërësisht mbipartiak, tërësisht kombëtar dhe tërësisht shtetformues e shpëtues, për një republikë dhe pluralizëm politik, që ndodhen tragjikisht në zgrip, si asnjë herë më parë.

Kushdo që do të evokonte të kundërtën e këtyre objektivave madhore të opozitës, duke i parqitur thjesht si objektiva partiake apo të një ndryshimi durarsh në pushtet, do të bënte thjesht një avokat të trashë e të akaparuar të qeverisë si dhe do të demonstronte një zbrazëti intelektuale të dhimbshme për atë vetë.

tur të parët në botë për nga numri i aplikimeve për azilantë në raport me popullsinë. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, emigracioni neto vitet e fundit (diferenca mes atyre që ikin dhe atyre që kthehen) është mesatarisht 15-20 mijë persona në vit që largohen nga vendi. Ndërsa në Kosovë, sipas të dhënave zyrtare, të cilave u referohet edhe Rtv 21, më 1 prill 2019, brenda 5 viteve, janë larguar si emigrantë mbi 170 mijë qytetarë ose rreth 34.000 në vit. Duke qenë se shumica janë të moshave të reja ika e tyre ka ndikim në uljen e martesave, të lindshmërisë dhe të rritjes së popullsisë. Kështu, po sipas INSTAT-it, numri i lindjeve në Shqipëri për tremujorin e dytë 2018 ishte 5.592, duke shënuar një rënie prej 25,3%, krahasuar me tremujorin e dytë 2017. Ndërsa shtesa natyrore e pop-

ullsisë për tremujorin e dytë 2018, pësoi një rënie me 69,9%, në krahasim me tremujorin e dytë 2017. Po me përmasa kaq të larta e masive, të frikshme dhe shqetësuese, papunësia, varfëria dhe emigracioni janë në mes të shqiptarëve edhe në Maqedoninë e Veriut, Preshevë, Medvegje e Bujanovc si dhe në Malin e Zi... Ky emigracion masiv, me tendencë rritjeje, shpjegohet sidomos me nivelin e ulët të të ardhurave dhe të mirëqenies. Shqipëria dhe Kosova renditen të fundit në Europë (pa përfshirë vendet e ish-Bashkimit Sovjetik) për të ardhurat për frymë, sipas të dhënave të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, në "Pasqyrën Ekonomike Globale" të tetorit 2018. Sipas një studimi të botuar në "Monitor", më 24.10.2018, për vitin 2018, Shqipëria vlerësohet të ketë të

ardhura për frymë prej 5261 dollarësh, në vend të 102 nga 191 shtete, kur sot një kg. presh, qepë, patate, mish, një litër ujë, qumësht, mjaltë, lëng frutash, birrë, verë, një biletë avioni, një paketë mujore celulari, interneti..., shiten dhe blihen me çmimet nga më të lartat në rajon dhe Evropë. Nuk është e rastit që raporti 2019 i lumturisë në botë i mbështetur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, publikuar më 20 mars 2019, e rendit Shqipërinë afar fundit të listës, në vendin e 106 ndër 156 vendet e analizuar. Kosova, me të ardhura për frymë prej 4,324 dollarësh, renditet e 112-a, ndërsa për lumturinë, paradoksalisht e 46-ta. Shumë vende më mirë se ne për lumturinë janë Serbia, në vendin e 70-të, Mali i Zi në të 73, Kroacia në vend të 75, Bosnje dhe Hercegovina në 78-in, Maqedonia në

të 84. Kështu, me këtë tablo dhe me këto shifra e fakte, bëhet e qartë se parashikimi apo ëndrra jonë për t'u bërë populli më i madh në Ballkan, me rreth 7-8 milionë banorë aty nga mesi i shekullit 21, "u vra" apo "u mbyt" në barkun e nënës" dhe "u varros për së gjalli", me shumë gjasa, duke u katandisur në rreth 800-900 mijë banorë... Atëherë, logjikshëm, mund të shtrohen, të paktën, katër pyetje: nga kush e kemi më shumë këtë gjëmë, që nga "parajsë" natyrore prej Zotit, Shqipëria të bëhet një "ferr tokësor" për robt e saj? Nga fajnjet apo nga vetvetja? Nga "gjasme e majta", që nga 1912-ta ka qeverisur de facto 74 vjet dhe de jure 62 vjet apo nga "gjasme e djathta" e sotme, që ka qeverisur...13 vjet? Shqipëria po "rilind" apo po mplaket, mpaqet, braktiset dhe...po "vdes"?

## HOROSKOPI

### DASHI

Çfarë sakrificash morale jeni të përgatitur për të bërë për të arritur qëllimet tuaja? Mos harroni se njerëzit e tjerë madje edhe konkurrentët tuaj janë qenie njerëzore ashtu si ju. Sa i përket dashurisë, gjëra të reja duken në sfond.

### DEMI

Nëse keni ndonjë plan udhëtimi, të gjitha shenjat tregojnë për një udhëtim shumë të suksesshëm, edhe pse një pengesë e vogël e minutës së fundit mund t'ju dalë përpara. Sot mund të afroheni më një person, i cili më parë nuk e kishte tërhequr vëmendjen tuaj.

### BINJAKET

Përzjerja e biznesit me kënaqësinë do të ishte shumë e rrezikshme për ju. Mbajeni zemrën në shtëpi dhe mendjen në punë. Në këtë mënyrë, do të keni më shumë sukses në të dyja fushat.

### GAFORJA

Sot mund të duket sikur po flet në një loj kodë dhe se vetëm njerëzit e pajisur me dekoderin e duhur mund të kuptojnë atë që po thoni. Për të parandaluar ndonjë keqkuptim të madh, përpuni të mbani një profil të ulët.

### LUANI

Ndodheni në një hapësirë të ndritshme dhe të gëzuar tani në jetën tuaj dhe duket sikur gjërat po ecin në drejtimin e duhur. Vlerësimi i gjërave të mira në jetën tuaj do të kontribuojë që të keni edhe më shumë gjëra të mira në rrugën tuaj.

### VIJGJERESHA

Të hapësh zemrën me dikë që sapo e keni njohur jo gjithmonë duhet të jetë një përvojë e frikshme. Nëse synoni romancë, do të jeni në gjendje t'i mbani të gjitha pritshmëritë tuaja realiste dhe të filloni një bisedë me dikë që ju intereson.

### PESHORJA

Sot do të arrini një pikë të rëndësishme, dhe do të ndiheni jashtëzakonisht krenarë për veten tuaj. Zgjidhni një daskë të këndshme për të festuar sukseset tuaja. Fokusit duhet të jetë mbi ju dhe arritjet tuaja.

### AKREPI

Një ofertë tunduese për përfitime të menjëhershme do t'ju zhysë në mendime. Nëse mendoni se nuk ia vlen, mos humbini kohë, por refuzojeni. Nuk është në interesin tuaj më të mirë që të hiqni dorë nga angazhimet tuaja.

### SHIGJETARI

T'i trajtoni konfliktet në një mënyrë të drejtëpërdrejtë është një strategji e mençur sot. Kjo do t'ju kursejë kohë dhe shumë dhimbje koke. Sa i përket aspektit profesional, mund të ketë zhvillime pozitive.

### BRICJAPI

Sot do t'ju duhet të shtyni veten pak më shumë se zakonisht, në mënyrë që të merrni atë ndjesi të shijshme suksesi. Në punë mund të arrini suksese nëse do të keni edhe mbështetje nga të tjerët.

### UJORI

Sot ju mungon vetëdisciplina dhe tani dhe do të ishte në interesin tuaj më të mirë për ta thyer atë në formë. Mos i thoni jo feseve për të dalë me miqtë, por njëkohësisht mos lini pas dorë disa detaje dhe angazhime që ju sjellin të mira financiare.

### PESHQIT

Jini më i hapur ndaj opinionëve të të tjerëve dhe në fund vendosni siç dëshironi ju. Dita mund të nisë me ndonjë surprizë të këndshme nga partneri. Në punë mund të merrni disa lajme pozitive.

**TRAJNERI I KUKËSIT**



Barazimi 2-2 në ndeshjen e parë në Durrës i jep Kukësit shanset të mëdha për kalimin në gjysmëfinale të Kupës së Shqipërisë. Ekipi i drejtuar në atë ndeshje nga Cungu, tashmë i larguar, ishte shumë afër fitores, sepse udhëhiqte 0-2, por u barazua në momentet e fundit nga Teuta. Për të mos i komplikuar gjërat,

**Ndreu: Barazimi na favorizon, por duhet kujdes me Teutën**

trajneri Ndreu kërkon nga të tjerët vlerësim maksimal të ndeshjes, që do të luhet nesër në "Elbasan Arena". "Rezultati 2-2 i ndeshjes së parë të favorizon në letër, por unë them se kërkon shumë kujdes, sepse mund të të vërë në gjumë. Nuk

duhet të mendojmë se jemi të kualifikuar. Nuk kemi arritur asgjë me barazimin e ndeshjes së parë. Kukësi është në një moment të mirë. Me Partizanin luajtëm mirë, krijuan volum loje, por nuk mundëm të fitonim. Megjithatë, kemi

besim në forcat tona. Mbrojtësi Ylli Shameti nuk do të luajë edhe në këtë ndeshje, nuk është ende gati. Tani jemi mësuar të luajmë në fusha të ndryshme, si në Elbasan, ashtu edhe në Shkodër, por e keqja është se kemi pak tifozë në këto stadione", - tha mes të tjerash për "RTSH Sport" trajneri i Kukësit, Ndreu.

Tekniku kryeqytetas beson se skuadra e tij do të arrijë të kualifikohet pas fitores 3-0 në ndeshjen e parë



Jeton Selimi

**Mema: Kush sulmon Tiranën bën gabim fatal**

*Trajneri kalon në kundërsulm pas vendimeve të Disiplinës*

Ardian Mema kalon në kundërsulm. Trajneri i Tiranës është totalisht i bindur se ndaj klubit bardheblu bë një gabim i madh, gabim që do të ketë pasojë më vonë, ashtu siç ka ndodhur me Partizanin, Dinamon e Vllazninë. Trajneri beson të kualifikimi në Kupë ndaj Laçit, për faktin se i jep shumë qetësi fitorja 3-0 në ndeshjen e parë, ndonëse, siç e pranon edhe ai vetë, kërkohej një menaxhim i mirë. Në fund, çështja Ngo-Laska, me Memën, i cili preferon të minimizojë tonet pas incidentit të fundit në "Selman Stërmasi".

**NDESHJA E KUPËS**

"Fakti është që kemi fituar 3-0. Duhet të menaxhojmë rezultatit, të ruajmë ekuilibrat e të jemi të kujdesshëm dhe ta mbarojmë ndeshjen në favorin tonë".

**SHERRI NDAJ LAÇIT**

"E para unë uroj që mos të ketë më kështu lloj ngjarjesh. Për sa i përket përkeqësimit të situatës, kjo është diçka që duhet të shuhet. Ne jemi për fushën lojës, nuk jemi as për grush-të apo kërcënime dhe gjëra të kësaj natyre. Shpresojmë që atje të luajmë futboll si duhet e te mos kemi presion. Besoj se do të ndodhë kështu. Ekipi është i qetë. Në Laç



do të shkojmë për të fituar".

**TENDENCË ANTI-TIRANË**

"Me sa kam marrë vesh në aspektin e gjobave jemi klubi më i penalizuar. Nuk mund ta mendoj këtë. Të sulmosh Tiranën është sikur të sulmosh djepin e futbollit shqiptar, janë disa skuadra si Tirana, Vllaznia,

Dinamo e Partizani që kanë vënë fillesat e futbollit shqiptar. E kam dëgjuar shpeshherë këtë. Mendoj se kushdo që ka ndërmend ta sulmojë Tiranën do të ketë pasojë nga mbrapa. E përsëris nuk besoj se do të ndodhë, por kushdo që e ka ndërmend do të bëjë një gabim fatal".

**DËMTIMET**

"Ndikojnë disi pasi ekipi ka marrë atë fizionominë e vet, por i kemi marrë masat me futbollistët e tjerë. Kemi rreth 25 futbollistë, të cilët janë të gatshëm për Tiranën".

**PENALIZIMET NGA GJYKIMI**

"Në memorien time është një ndeshje që kemi pasur me Teutën në Shijak dhe ndeshja ndaj Kastriotit në Fushë-Krujë. Të them të drejtën nuk na kanë bërë gjë arbitrat dhe në ndeshjen e fundit ndaj Laçit më shumë u mora me ekipin, pasi shtesa nuk ishte justifikim. Ishim superiorë në çdo aspekt, nuk kishim pse ta vendosnim në diskutim atë ndeshje. Për sa i përket shtesës, shpeshherë bisedoj me shokët e mi dhe them: 'A do ta bënte këtë gjë në Laç? Kurrë!' Gjithsesi unë merrem me ekipin me arbitrin, pasi kjo është puna ime. Ky ka qenë rasti i vetëm që klubi ka reaguar për një ven-

**DËNIMI PËR TIFOZËT**

"Ne kemi luajtur goxha pa tifozë, edhe kjo nuk na ka bërë mirë të them të drejtën. Tifozeria e Tiranës është pjesë përbërëse dhe një ndihmë që na garanton sukses. Tani do t'i bëjmë llogaritë pa tifozët, por të shohim si do të shkojnë gjërat".

dim të arbitrit. Arbitrat kanë punën e tyre dhe në vitet e fundit kanë ndikuar shumë. Ata mund të ndikojnë të karriera e një trajneri dhe investimi i një presidenti. Gjithsesi unë konstatoj vetëm këto dy ndeshje, ndërsa pjesa tjetër ka qenë krejt normale".

**REAGIMI I NGO**

"Nga ka atë karakter që ka. Kur shkon nga një shtet tjetër mëson fillimisht fjalët e këqija, siç duket atij ia kanë vrarë veshin shumë ato fjalë dhe ka reaguar, por nuk është diçka e mirë pasi është futboll. Megjithatë nuk mund t'i flitet me ato fjalë. Unë di që edhe ai gjyqtari në Fushë-Krujë e ka ironizuar me fjalë, duke i përmendur dhe ngjyrën e lëkurës. Nuk mund të cenosh dinjitetin e ndokujt".

**FORMA E EKIPIT**

"Ne kemi bërë një fazë të tretë të shkëlqyer. Ekipi ka luajtur ndeshje shumë të mira dhe ka marrë rezultate, kjo më jep garanci për të ardhmen. Gjithsesi, patëm një frenim me dashje në Fushë-Krujë dhe kjo më ka bezdisur, pasi ekipi ndodhej në goxha ritëm. Me presidentin Laska njihemi prej vitesh nuk ka përse të ndodhin këto gjëra, sidomos në Tiranë ku ka qetësi. Duhet të jemi kujdesshëm. Është e thjeshtë nuk duhet të merremi fare me kundërshtarin. Njëherë duhet të tregohem më të përgjegjshëm për gjërat që bëjnë, duke filluar nga sharjet që ndodhin në shpesh në stadiumet e qyteteve të vogla dhe nga hedhja e shisheve, që ne na bëri dëm, na la katër javë pa tifozë. Duhet të merremi me futbollin jo me akte rruqçerërie".

**78 mijë euro dhe një orë**

**Kishte pranuar dhurata, dorëhiqet presidenti i federatës gjermane**

DFB-Meiden, kompani e kontrolluar nga federata, por nuk e kishte deklaruar këtë shumë. Gjithashtu, edhe një orë prej 6 mijë eurosh, dhuratë nga ana e kolegut të tij ukrainas Grigori Surkis nuk është deklaruar nga Grindal. Grindal ishte në krye të detyrës që prej 15 prillit të vitit 2016, ndërsa pas

eliminimit të Gjermanisë nga Kupa e Botës edhe lënies jashtë skuadrës Kombëtare të tre lojtarëve të Bajern Mynihut, Myler, Humels dhe Boetang, ia lëkundën fuqishëm pozitën. Emri më i lakuar për të marrë vendin e tij është ai i Filip Lahm, ish-kapitenit të Gjermanisë dhe Bajernit të Mynihut.

**Do të kushtojë 500 milionë euro**

**Perez: "Bernabeu" i ri do të jetë ikonë për Madridin**




të Realit të Madridit, Florentino Perez, do ta shndërrojë stadiumin në

një ikonë të kryeqytetit spanjoll. "Është vendi që është admiruar për 117 vite. Akoma ëndërrime ta bëjmë Realin një ndër klubet më të admiruara në botë. Ky klub i përket gjithë madrienëve dhe nuk menaxhohet për të përfituar. Ky stadium do të jetë ikonë për klubi dhe qytetin".

Kishte pranuar dhu-rata dhe ndere, është zbuluar dhe ka dhënë dorëheqjen. Natyrisht kjo nuk ka ndodhur në Shqipëri, por në Gjermani, me një nga presidentët më të fuqishëm në botën e futbollit, Reinhard Grindel, i cili ka përfunduar në shënjestrën e mediave gjermane, të cilat e kishin paralajmëruar këtë qëndrim të Grindel. 58-vjeçari kishte marrë 78 mijë euro gjatë periudhës së qëndrimit të tij në krye të qeverisë së futbollit gjerman nga

**Fjalëkryqi (1)**



HORIZONTAL

- Janë rivalë.
- Kurosawa, regjisori i Rashomon
- Janë fushat sportive.
- Memoria në computer
- Inicialet e Konicës.
- Halili këngëtare
- I famshmi Pacino.
- Ishtin kalorësit e Karlit të Madh
- Fundet pa fund.
- Është shenjë goditjesh.
- Giberna në MotoGP.
- Janë kulla në xhami.
- Ente Tregtare Durrës.
- Janë temperaturat më të ulëta.
- Christian i modës
- Pak anakronike.
- Erwin që thirrje Dhepra e shkretëtirës.
- Është garë sipërmarrësish.
- Në fillim të verës

- Diego pa çifte.
- Të fundit në tender.
- Mund të jenë kuzhine.
- Mbyllin një krah
- Merret nga ai që çan ferrën.
- Kufij tinerari.
- Një... italiane.
- Një treshe në skenë.
- Ka ndodhur.

VERTIKAL

- Jessica Parker aktore.
- Basinger aktore.
- Mbetur në fund.
- Fillojnë nazet.
- Të parat në stadium.
- Parashitesë për gjysmë.
- Një mund të jetë ekspres
- Janë ndalime në pranga.
- Marina këngëtare italiane.
- Mund të jetë autonome.
- Një sallë për drama.
- Është laps.
- Është bota e luleve
- Trëndafili i Japonisë.
- Një bukë që hahej me qofte.
- Janë kapo kozakë.
- Ndryshon një çdo ditë.
- Punon në galeri.
- Emri tjetër i Esaut.
- Emri i dikurshëm i Tokyo-s
- Një mund të jetë arkëtimi.
- Një vrap pele.
- Kujtohet në nostalgji në pleqëri.
- Franz kompozitor
- Një lumë i yni.
- Mbarojnë fare.
- Qerre pa qe.
- Ente Industriale Rajonale.
- Qendër në kaos.
- Inicialet e Gide.
- Ditngon në dur.


**Fjalëkryqi (2)**

HORIZONTAL


- U shpik nga Volta.
- Janë si kasolle
- Negri ppete italiane.
- Mund të jenë edhe plehrash.
- Fillojnë raportin
- Mbarojnë kurse
- Emër djali.
- Sharif aktor.
- Ai dhe ajo.
- U verbua nga Askush
- Kanë mbetur në klasë.
- Ishte djali tjetër i Odiseut.
- Topat pa kufij.
- Janë edhe ato ultraviolet.
- Në krye të noterëve.
- Një Baba përrallor.
- Rrota pa ekstreme.

VERTIKAL


- Ato biometrike nuk kanë nevojë për viza
- Lindin në kokë
- Nota e diapazonit
- Janë të përpjeta.
- Një këngëtar lirrik.
- Mbyllin një dyqan.
- Mbarojnë fare
- Është grimcë me bërthamë.
- Është lloj papagalli.
- Paguhet për shërbim.
- Mund të jenë kasketa.
- Personazh i njohur i Woody Allen.
- Flet për Pegason dhe Belerofontit.
- Është enë kryesore gjaku.
- Është dukuria.
- Besim pa kufij
- Si stinore.
- Mund të ishin bukanierë.
- Mbyllin portat.
- Claude-Oscar piktor.
- Është shkronjë e rezistencës
- Lumë në Francë.
- Pak dendësi.
- Raset pa set
- Fillojnë detyrën.
- Rastisin në krye.
- Inicialet e Magritte piktor.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		7			9			
		4		2				
5					8			2
	3	9				7	5	
8						3		9
			6					
6			1	4				5
								7
			5		4	3		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	7	2	4	1	9	5	8	3
8	5	1	2	3	7	6	9	4
9	3	4	5	8	6	7	1	2
1	2	6	8	4	5	9	3	7
7	8	9	3	6	1	2	4	5
5	4	3	9	7	2	8	6	1
2	1	8	6	5	4	3	7	9
3	9	7	1	2	8	4	5	6
4	6	5	7	9	3	1	2	8

*Argëtim filozofik*

- Nëse nuk shikoni atje ku ju doni të shkoni, atëherë, do të shkoni atje ku ju shikoni.

- Mënyra për të jetuar më mire dhe më i përzgjedhur është ajo e mendimitarit, sepse, që ta themi pa e zgatur atë që ka rëndësi, ai ka më shumë nevojë për gjërat që të tjerët i përcmojnë dhe i braktisin.

- Nuk është dëshmitar nëse nuk arrini atë që ju synoni. Dëshmitar është nëse ju nuk e provoni përsëri.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	9	3	18		15	1	16		13	1	1	M	A	S	H	U	R	K	A	I	R	A	K
3	9	2	12		10	1	9		8	1	12	1	E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A	
4	1	18		15	3	9	2	18	3	8	3	9	I	T	E	A	T	E	R	M	I	N		
10	8		16	3	4	3		17	4	6			E	R	A	P	O	L	A	R	T	A		
3		12	1	15	2	8	1	11	2	7	8	3	K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T
12	3	3		15	9	1		11	7		9	15	L	P	O	L	I	G	A	M	I			
3	3	18	1	6		12	1	8		3	2		E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L	
8		19	1	9		19	6	9		3	16	8	K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E	
13	F	O	R	D		3	18	2	11		8	3	T	R	I	S	E	T	M	N	U	N		
5	1	9	2		3	4	2		2	4	1	8	I	T	T	U	T	U	I	T	I	D		
1	11	3	1	8	3		12	1	18	1	9	3	K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E	
8	11	6		19	1	4	3	7	1		2	8	E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T

*Thënie të mençura*

- E fillon duke harruar të duash të tjerët,
- dhe përfundon duke mos gjetur më asgjë
- tek vetja jote që të jetë e denjë për t'u
- dashur.
- Ju qeshni me mua sepse unë jam
- ndryshe. Unë qesh me të gjithë ju që
- jeni të njëjtë.
- Atje ku hapet një shkollë, mbyllet një
- burg.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

P E T R I K A A S P A K  
T R U P T A L E N T I A  
B R P A N T E R A N  
B E L S A N D O K A N  
B A K U N I O A N E M I  
P T A M A R O C I T H  
P I E E N A O D R E  
A E T O N E K A L M A  
R A T R A D E A L M A  
K E M A P E T E A P  
E L S A V A L R O N E  
R I T M A L L A R M E T

FJALËKRYQI (1)

*Argëtim filozofik*

FJALËKRYQI (2)

